



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Infermieri”
Kolegji Universitar “REALD”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Gazment KODUZI

Dr. Niko HYKA

Tetor / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në: “Infermieri”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “REALD”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Teknike Mjeksores
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Infermieri”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 258, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Studime me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit 2022- 2023	12 PAE dhe 8 PAK Për sa i përket ngarkesës (67 % / 33%)
18	Numri i studentëve:	- 2020-2021; 21 studentë; - 2021-2022; 54 studentë; - 2022-2023; 44 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar “Reald”(KUR) është një institucion privat i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 650, datë 14.09.2011, si Akademia e Studimeve të Aplikuara “Reald”. Në vitin 2017 është riorganizuar duke marrë emrin Kolegji Universitar “Reald”. Institucioni ka shtuar një departament të ri (Departamenti i Veterinarisë), me Vendim Senati Nr. 2, datë 27.09.2021, konfirmuar me shkresën e MAS Nr. 5324/4 Prot., datë 09.09.2022. Me Vendim Senati nr. 9, datë 09.09.2022, KUR ka miratuar ndryshimin në shtojcën e statutit, ndryshim i cili është miratuar me Urdhër të MAS nr. 731, datë 09.12.2022.



Ky institucion është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr. 93, Vendim BA datë 20.10.2017 dhe ka kryer procesin e riakreditimit në vitin 2022. Aktualisht institucioni është në fazën e vendimmarrjes nga Bordi i Akreditimit.

KUR përbëhet nga 2 njësi kryesore, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Secili fakultet përbëhet nga 3 njësi bazë, si vijon:

- Fakulteti i Ekonomisë:
 1. Departamenti i Financës;
 2. Departamenti i Menaxhimit;
 3. Qendra Kërkimore;
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore:
 1. Departamenti i Farmacisë;
 2. Departamenti i Stomatologjisë;
 3. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore;
 4. Departamenti i Veterinarisë;

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri” fillimisht është hapur në gjuhën shqipe me 180 kredite, kohëzgjatje normale 3 vite akademike.

Me Urdhër Nr. 463 datë 27.07.2018 , të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë është bërë riorganizimi i programit në masën 20%, duke u riorganizuar në 180 kredite, në gjuhën shqipe dhe italiane, kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në fund të studimit lëshohet diplomë “Bachelor” në “Infermieri” e përbashkët me Universitetin e Foggias, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndër-institucional për këtë qëllim. Me Urdhër Nr.258 datë 19.07.2021 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, programi riorganizohet në masën 20%, kthehet në program në gjuhën shqipe, 180 kredite, 3 vite akademike. Ky proces akreditimi është i pari pas riorganizimit të programit të studimit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të programit të studimit Bachelor në “Infermieri” (BI), i ofruar nga Kolegji Universitar “REALD”, (KUR). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të parë për Bachelorin, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. [ascal.al]

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e vlerësimit [ascal.al] të miratuar nga ASCAL/BA dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga ASCAL sipas të cilave procesi i vlerësimit në institucion u zhvillua në datat 12.06.2023 - 13.06.2023.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks [aneks, lista e evidencave].

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof.As. Gazmend Koduzi dhe Dr. Niko Hyka. Koordinatore Teknikë e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Majlinda Demirneli


Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në KUR e zhvilluar në datat 12 dhe 13 Qershor 2023. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e KUR.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu GVJ vlerëson edhe adresimin e bëra nga ana e institucionit në përmbushje të rekomandimeve të lëna në akreditimin e mëparshëm. Njëkohësisht GVJ falenderon ASCAL dhe Koordinatorin Teknik për mënyrën e menaxhimit dhe korrektësinë e treguar gjatë gjithë procesit.

Kolegji Universitar "REALD" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 13.09.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 141/26 Prot, datë 13.09.2023. Kolegji Universitar "REALD" më datë 18.09.2023, njofton nëpërmjet shkresës me Nr.337 Prot, datë 14.09.2023 " Dërgojmë komentet tona lidhur me Draft Raportin", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Infermieri”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE



Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Kolegji Universitar REALD ofron programe të licensuar nga Ministria e Arsimit, në përputhje me interesat kombëtare, të cilat synojnë aftësimin e studentëve dhe rritjen e mundësisë të punësimit të tyre në fushën e infermierisë, duke u siguruar studentëve një bazë të fortë teorike dhe praktike në kujdesin infermior, dhe i përgatit që të jenë të aftë të punojnë si në sektorin publik ashtu edhe atë privat, në Shqipëri apo jashtë saj. Ky program ruan traditën e shkollës së mesme mjeksore “Jani Minga” ku edhe një pjesë e personelit akademik janë produkt i kësaj shkolle.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit bachelor në Infermieri është i hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e Kolegjit Universitar REALD, të përcaktuar në Statutin e KUR, miratuar me Vendim nr. 56, datë 07.12.2016 të Senatit Akademi, dhe Miratuar me Urdhër nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Neni 4 “Qëllimi dhe misioni i Kolegjit Universitar REALD”. Kolegji Universitar “REALD” e ofron programin Bachelor në Infermieri që prej themelimit të tij, dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjeksore, i cili është një nga departamentet bazë të tij. <i>Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD, Miratuar me Urdhër nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Programi i studimit bachelor në Infermieri është i hartuar dhe ofrohet në përshtatje me dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim 2021 – 2026 të Kolegjit Universitar “REALD”, miratuar me Vendim nr. 6, datë 02.06.2020 të Bordit të Administrimit, Statutit të KUR, miratuar me Vendim nr. 56, datë 07.12.2016 të Senatit Akademi, dhe Miratuar me Urdhër nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, si dhe Rregullore e KUR, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademi.

	<p><i>Evidenca nr. 3. Strategjia e zhvillimit 2021 – 2026 miratuar me Vendim nr. 6, datë 02.06.2020 të Bordit të Administrimit;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD, Miratuar me Urdhër nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit;</i></p> <p><i>Evidenca nr.4. Rregullore e KUR, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik;</i></p>																																								
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” që prej themelimit të tij bazuar në VKM Nr. 650 datë 14.9.2011 “Për licensimin e Akademisë së Studimeve të Aplikuara “REALD”, ka pjesë të tij Fakultetin e Shkencave Mjekësore, që do të ofrojë programin Bachelor në Infermieri, çfarë tregon që ka përvojën e duhur.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 61 pedagogë, nga të cilët 48 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 13 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm: <i>(Evidenca nr. 85. Tabelat permbledhese per Anels-RVB per programin Bachelor ne Infermieri tab 1 dhe 2)</i></p> <table border="1" data-bbox="560 891 1353 1144"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Shkencave Mjekësore</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>3</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>-</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>18</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>27</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>48</td> <td>13</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ndërsa Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore; si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023, ka këtë paraqitje:</p> <table border="1" data-bbox="560 1346 1353 1630"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>-</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>5</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>10</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>15</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjithashtu, KUR ka burimet e duhura logjistike për të ofruar një mësimdhënie sa më cilësore, përmes laboratorëve të anatomisë humane, farmacisë, kimisë, informatikës, si dhe praktikave të nevojshme përmes kontratave me spitalin Rajonal të Vlorës, Spitalit Psikiatrik në Vlorë, Poliklinikës Vlorë, Spitalit Rajonal Fier.</p>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore		PAE	PAK	Prof.Dr	3	1	Prof.Asoc	-	2	Dr/PhD	18	6	Msc	27	4	Gjithsej	48	13	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore		PAE	PAK	Prof.Dr	-	-	Prof.Asoc	-	2	Dr/PhD	5	1	Msc	10	3	Gjithsej	15	6
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore																																								
	PAE	PAK																																							
Prof.Dr	3	1																																							
Prof.Asoc	-	2																																							
Dr/PhD	18	6																																							
Msc	27	4																																							
Gjithsej	48	13																																							
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore																																								
	PAE	PAK																																							
Prof.Dr	-	-																																							
Prof.Asoc	-	2																																							
Dr/PhD	5	1																																							
Msc	10	3																																							
Gjithsej	15	6																																							




<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi Bachelor në Infermieri ofrohet bazuar në përcaktimet për emërtimin, organizimin dhe strukturën në Ligjin Nr.80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL, Neni 20, Statutit të KUR, dhe Rregullores së Studimit. Programi Bachelor në Infermieri bën pjesë në nivelin e 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, është emërtuar sipas fushës së studimit në infermieri. Fusha e përgjithshme e studimit është në përputhje me fushën akademikë të Fakultetit të Shkencave Mjeksores, ndërsa fusha specifike është në përputhje me njësinë bazë – Departamentin e Shkencave Teknike Mjeksores.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kolegji Universitar "REALD" ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, të përshkruara në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, si dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të KUR, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij..</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së</p>	<p>Programi Bachelor në Infermieri, ofruar nga Kolegji Universitar "REALD", që prej themelimit të tij bazuar në VKM Nr. 650 datë 14.9.2011 "Për licensimin e Akademisë së Studimeve të Aplikuara "REALD", është program nën kujdestarinë e Fakultetit të Shkencave Mjeksores (FSHM) dhe Departamentit të Shkencave Teknike Mjeksores. FSHM kryen kordinimin midis departamenteve të tij për kryerjen e programit, si dhe marrëdhëniet me të tretët ku studentët kryejnë praktikën mësimore. Pjesë e punës koordinuese është përgatitja e ngarkesës mësimore, përcaktimi i titullarëve të lëndëve sipas kërkesave të rregullores institucionale.</p>






vazhdueshme të punës së tyre.	<i>Evidenca nr.4. Rregullore e KUR, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik;</i>			
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Kolegji Universitar “REALD” me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione mësimore dhe struktura spitalore për praktikat. Kolegji ka marrëveshje me Universitetin “I.Qemali” Vlorë, Universitetin e Salernos – Itali, Spitalin Rajonal Vlorë, Spitalin Psikiatrik Vlorë, Spitalin Rajonal Fier. <i>Evidenca nr.24-29. Lista e institucioneve dhe e marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL dhe spitale për kryerjen e praktikave profesionale;</i>			
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Për realizimin e programit të studimit , Kolegji Universitar “REALD” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me struktura spitalore për praktikat profesionale, klinike me : Spitalin Rajonal Vlorë, Spitalin Psikiatrik Vlorë, Spitalin Rajonal Fier. <i>Evidenca nr.24. Lista e subjekteve me të cilat Ial ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave profesionale;</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Shkencave Mjeksore Teknike si njësia përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Infermieri, cdo fund viti harton raportin analitik vjetor për realizimin e objektivave të marrëveshjeve ndërinstitucionale për praktikat profesionale dhe klinike. <i>Evidenca nr. 76. Analiza vjetore e Departamentit për realizimin e programeve dhe praktikat mwsimore 2021-2022;</i>			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar “REALD” ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione arsimore IAL vendase dhe të huaja. Kolegji ka marrëveshje me Universitetin “I.Qemali” Vlorë, Universitetin e Salernos – Itali, Spitalin Rajonal Vlorë, Spitalin Psikiatrik Vlorë dhe Spitalin Rajonal Fier në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
I				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR



Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Infermieri është i organizuar në lëndë sipas kategorisë (A,B,C,D,E), lëndë dhe module , sipas Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe Udhëzimit Nr.41 të MASR datë 24.01.2018, si dhe VKM Nr.824 datë 24.12.2021 “Për miratimin e kodit të cilësisë në arsimin e lartë”.</p> <p>Plani mësimor është i organizuar në 3 vite akademikë, 6 semestra, 30 kredite cdo semestër, 180 kredite gjithë programi. 1 kredit ekuivalentohet me 25 orë mësimore. Programi ka 4500 orë mësimore në total, ku mbi 50% e tyre janë orë jashtë auditorit.</p> <p><i>Evidenca nr. 7. Rregullore e programit të studimit Bsc në Infermieri, e ndryshuar, Miratuar me Vendim nr. 5 datë 25.05.2022 të Senatit Akademik;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 47. Program mësimor, cikli i parë i studimeve “Bachelor” në “Infermieri”viti akademik 2021-2024, Miratuar me Urdhër nr.257 datë 19.07.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri,</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Infermieri përmes sylabuseve dhe strukturës mësimore dhe praktikës profesionale, synon përgatitjen e infermirëve që ofrojnë kujdes shëndetësor për një rang të gjerë patologjish dhe grupe moshore, komunikimit ndërpersonal me pacientët dhe familjarët, si dhe manipulimet e ndryshme (injeksione, mjeksim plagësh). Këto objektiva janë të përacaktuara edhe në “Rregulloren e programit të studimit Bsc në Infermieri “ miratuar me Vendim Nr.41 datë 24.09.2020 të Senatit Akademik.</p>

aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<i>Evidenca nr. 7. Rregullore e programit të studimit Bsc në Infermieri, e ndryshuar, Miratuar me Vendim nr. 5 datë 25.05.2022 të Senatit Akademi;</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit Bachelor në Infermieri ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese të grupuar në lëndë sipas kategorisë (A,B,C,D,E), lëndë dhe module, sipas Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë” si dhe Udhëzimit Nr.41 të MASR datë 24.01.2018, si dhe VKM Nr.824 datë 24.12.2021 “Për miratimin e kodit të cilësisë në arsimin e lartë”. Programi mësimor përmban ngarkesën në kredite për cdo lëndë. <i>Evidenca nr. 47. Program mësimor, cikli i parë i studimeve “Bachelor” në “Infermieri”viti akademik 2021-2024, Miratuar me Urdhër nr.257 datë 19.07.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.	Referuar programit mësimor të studimit është lëndë e kategorisë D dhe është specifikuar qartë ngarkesa në kredite për realizimin e praktikave, respektivisht: <ul style="list-style-type: none"> - 3 kredite vitin e parë; - 7 kredite vitin e dytë dhe të tretë; - 6 kredite teza e diplomës; <i>Evidenca nr. 47. Program mësimor, cikli i parë i studimeve “Bachelor” në “Infermieri”viti akademik 2021-2024, Miratuar me Urdhër nr.257 datë 19.07.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim	Sipas dokumentit të propozimit për hapjen e programit të studimit dhe sipas rregullores së funksionit të programit të cilat u shqyrtuan nga GVJ, ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015. KU “Reald”, nuk gëzon status të veçantë, pra kjo pjesë e këtij kriteri nuk zbatohet për këtë institucion.




të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Referuar RVB programi Bachelor në Infermieri është emërtuar, organizuar dhe sturkutruar sipas Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë” si dhe Udhëzimit Nr.41 të MAS datë 24.01.2018, si dhe VKM Nr.824 datë 24.12.2021 “Për miratimin e kodit të cilësisë në arsimin e lartë”, Nenit 4 të Statutit të Kolegjit, Rregullores së Kolegjit, që të ketë përmbajtje të ngjashme në nivel të paktën 70% me programe Bachelor në Infermieri të ofruara nga institucione të tjera. Programi i studimit Bsc në “Infermieri” është i njëjtë me programe studimi në të njëjtën fushë dhe me të njëjtën emërtesë, të ofruar nga Universitetin “I.Qemali” Vlorë në masën 70%. Kjo lehtëson mobilitetin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Sipas programit të studimit Bachelor në Infermieri viti akademik 2021-2024, Miratuar me Vendim nr. 41, datë 24.09.2020, të Senatit Akademik, Miratuar me Urdhër nr. 257, datë 19.07.2021, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, ka kodin e programit 63BA0913S, është pjesë e ciklit të parë të studimeve, referuar nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve organizohet me 180 ECTS dhe kohëzgjatje normale 3 (tre) vite akademike me kohë të plotë, miratuar me Urdhër nr. 258, datë 19.07.2021, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit Bsc në “Infermieri” shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit, dhe më tej çdo lëndë është kodifikuar sipas planit.</p> <p><i>Evidenca nr. 47. Program mësimor, cikli i parë i studimeve “Bachelor” në “Infermieri” viti akademik 2021-2024, Miratuar me Urdhër nr.257 datë 19.07.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit,</i></p> <p><i>Evidenca nr.49. Plani mësimor bachelor në infermieri;</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Infermieri, është konceptuar si program i përbashkët me Universita degli Studi di Foggia, por për arsye procedurale nuk u realizua nga pala italiane, dhe u riorganizua me Urdhër Nr. 258 datë 19.07.2021 “Për riorganizimin nga program i përbashkët studimi të ciklit të parë Bachelor në Infermieri, në program të ciklit të parë Bachelor në Infermieri në Kolegjin Universitar “REALD”</p> <p><i>Evidenca nr. 23. Urdhër Nr. 258 datë 19.07.2021 “Për riorganizimin nga program i përbashkët studimi të ciklit të parë Bachelor në Infermieri, në program të ciklit të parë Bachelor në Infermieri në Kolegjin Universitar “REALD”;</i></p>

Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në Infermieri është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi, Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë” si dhe Udhëzimit Nr.41 të MASR datë 24.01.2018, si dhe VKM Nr.824 datë 24.12.2021 “Për miratimin e kodit të cilësisë në arsimin e lartë, si dhe Statutin dhe Rregulloren e brendshme.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2																					
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.																					
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																				
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Shkencave mjeksore dhe Departamenti i Shkencave Tekniko Mjeksore pranë Kolegjit Universitar “REALD” janë të organizuara bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Njësia kryesore (FSHM) është e përbërë nga 4 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Tekniko Mjeksore; 2. Departamenti i Farmacisë; 3. Departamenti i Stomatologjisë; 4. Departamenti i Veterinarisë; <p>Fakulteti i Shkencave Mjeksore, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 61 pedagogë, nga të cilët 48 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 13 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm: <i>Evidenca nr. 85. Tabelat përmbledhese për Anels-RVB për programin Bachelor në Infermieri tab 1 dhe 2;</i></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Shkencave Mjeksore</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>3</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>-</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>18</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>27</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>48</td> <td>13</td> </tr> </tbody> </table> <p>Cdo njësi bazë është e përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Njësia bazë,</p>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjeksore		PAE	PAK	Prof.Dr	3	1	Prof.Asoc	-	2	Dr/PhD	18	6	Msc	27	4	Gjithsej	48	13
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjeksore																				
	PAE	PAK																			
Prof.Dr	3	1																			
Prof.Asoc	-	2																			
Dr/PhD	18	6																			
Msc	27	4																			
Gjithsej	48	13																			

Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Infermieri”, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	0	-	-	-	-
Prof. Asoc.	-	1	-	1	-	2
Dr./PhD.	3	2	5	3	5	1
Msc.	6	4	8	3	10	3
Totali	10	7	13	7	15	6

Institucioni Kolegji Univesitar “REALD” ka marrë akreditim institucional me vendim nr. 93, datë 20.10.2017 nga Bordi akreditimit ACSAL.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Njësia bazë që organizon programin e studimit Bachelor në “Infermieri”, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, bazuar në shpërndarjen e orëve mësimore në stafin pedagogjik.

Njësia bazë me Urdhër nr. 1 datë 20.01.2023 “ Për caktimin e personelit akademik që do të realizojë praktikat mësimore, laboratorike e klinike, në programin e studimit Bachelor në Infermieri dhe Bachelor në Fizioterapi” të Përgjegjës të Departamentit, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.



Evidenca nr. 63. Urdhër i përgjegjës të departamentit për caktimin e personelit akademik që do të realizojë praktikat mësimore, laboratorike e klinike, në programin e studimit Bachelor në Infermieri dhe Bachelor në Fizioterapi:

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e


Bazuar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, Përgjegjësi Departamentit ngarkohet me detyrat e

<p>koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>kordinatorit të programit të studimit. Këto detyra përshkruhen në <i>Nenin 8</i>: Përgjegjësi i Departamentit</p> <p>Përgjegjësi i departamentit është autoriteti më i lartë akademik për departamentin. Detyrat dhe kompetencat e tij janë :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Drejton punën për hartimin e planeve mësimore dhe programeve të lëndëve që mbulon departamenti dhe ndjek zbatimin e tyre; 2. Ndjek dhe kontrollon aktivitetin shkencor në departament, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e aktiviteti shkencor dhe akademik të anëtarëve të departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij; <p><i>Evidenca nr. 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, neni 8;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore pranë Kolegjit Universitar "REALD", përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Infermieri, janë të organizuara bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi II.3</p> <p>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në RVB si edhe informacionet publike të Institucionit në faqen e tij të Internetit (Plani Mësimor i Programit të Studimit, udhëzime për studentët, etj), dhe konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programit të studimit "Bsc në Infermieri" në KU "Reald" disponohen nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore (njësia kryesore) dhe Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore (njësia bazë) si edhe elementet kryesore të tyre janë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht.</p> <p><i>Evidenca nr. 7. Rregullore e programit Bsc në Infermieri;</i> <i>Evidenca nr. 8. Rregullore për Zhvillimin e Provimeve;</i></p>

	<i>Evidenca nr. 9. Rregullore e diplomimit;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>Programi i studimit Bachelor në Infermieri, është organizuar sipas kërkesave të VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët janë të grupuara sipas kategorive dhe përqindjeve të krediteve të Tabelës nr.1, shtojca 1, VKM nr.41, datë 24.01.2018. Programet e studimit janë të organizuar në :</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Lëndë bazë A me 29 kredite=16.2% ➤ Lëndë Karakterizuese B me 97 kredite = 53.9% (A+B=126 kredite>70%) ➤ Lëndë ndërdisiplinore integrale C me 24 kredite = 13.3% ➤ Lëndë plotësuese D me 24 kredite = 13.3% ➤ Lëndë përmbyllëse E me kredite – 3.3% <p>Bazuar në planin mësimor, cdo kredit korespondon me 25 orë mësimore, ku përfshihen orë në auditor dhe orë jashtë auditorit.</p> <p><i>Evidenca nr. 47. Programi mesimor Bachelor në Infermieri 2020-2023 - i riorganizuar;</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Programi i studimit Bachelor në Infermieri është organizuar bazuar në “Rregulloren e programit të studimit BSc në Infermieri, e ndryshuar” miratuar me Vendim nr. 5, datë 25.05.2022 të Senatit Akademik, ku në <i>Nenin 8</i> përcaktohen kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit.</p> <p>Në <i>nenin 26</i> të Rregullores përcaktohen kushtet për procedurat dhe modalitetet për transferimin e studentëve dhe ekuivalentimin e studimeve.</p> <p><i>Evidenca nr. 7. Rregullore e programit Ba. në Infermieri-miratuar me Vendim nr. 5 dt. 25.02.2022 te SA;</i></p>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në	<p>Programi i studimit Bachelor në Infermieri, dhe programet lëndore të tij (syllabuset) janë të përgatitura bazuar në kërkesat e VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL “ shtojca 2.</p> <p>Në syllabuse janë të përshkruara qartë praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p><i>Evidenca nr. 50. Syllabuset;</i></p>






përputhje me formatet e miratuara.							
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>Përmbajtja e programit Bachelor në Infermieri i është nënshtruar ndryshimeve dhe përmirësimeve në masën mbi 20% së fundmi me Urdhër nr. 258 datë 19.07.2021 “Për riorganizimin nga program i përbashkët studimi të ciklit të parë Bachelor në Infermieri, në program të studimit të ciklit të parë Bachelor në Infermieri, në kolegjin Universitar “REALD”. Këto ndryshime janë bërë me miratim të Senatit Akademik Nr.41, datë 24.09.2020, çfarë tregon për një proces përmirësimi të brendshëm të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 35. Vendim i SA nr. 41, datë 29.04.2020, për riorganizimin në masën mbi 20% të programit të studimit Bachelor në Infermieri;</i></p> <p><i>(=Evidenca nr. 23. Urdhër i MASR nr. 258, datë 19.07.2021, Për riorganizimin nga program i përbashkët studimi të ciklit të parë Bachelor në Infermieri, në program të ciklit të parë)</i></p>						
Konkluzione	<p>Programi i studimit Bachelor në Infermieri është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. Programi i studimit Bachelor në Infermieri, është organizuar sipas kërkesave të VKM Nr.41, datë 24.01.2018“Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët janë të grupuara sipas kategorive dhe përqindjeve të krediteve të Tabelës nr.1 shtojca 1, VKM nr.41, datë 24.01.2018.</p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					



Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë,	Programi mësimor në Bachelor Infermieri është i përbërë nga leksione, seminare, laboratorë dhe praktika. Shpërndarja dhe emërimi i lëndëve, sipas kategorive, në lëndë bazë, karakterizuese ndërdisiplinore, plotësuese dhe formuese, japin

<p>thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>mundësi në thellimin e njohurive dhe aftësive praktike për punësim, ose studime të mëtejshme. Programi i studimit ofron praktika mësimore prej 2-4 orë në javë, dhe profesionale 8 orë në javë, që janë bazat e përfitimit të aftësive profesionale.</p> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani mësimor i programi bachelor në infermeri;</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Programi Bachelor në Infermieri është i organizuar në 3 vite, 6 semestra, 180 kredite.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin e parë të studimeve hidhen bazat e formimit të përgjithshëm dhe shëndetësor: biologji, anatomi, bazat e infermieristikës, terminologjia mjeksore, fiziologji, deontologjia, etj. - Në vitin e 2 dhe të 3 studenti ndjek lëndët e formimit klinik dhe infermioror: sëmundjet e brendshme, kirurgji, pediatric, neurologji, gjinekologji, sëmundje infective, etj. <p>Studentët kryejnë praktika profesionale gjatë 3 viteve, ku në semestrin e fundit 2 ditë në javë, në cdo repart të spitalit. Shpërndarja e krediteve është bërë në varësi të kategorisë së lëndës, orëve mësimore dhe rëndësisë së saj, psh. Anatomia humane ka 7 kredite, bazat e infermierisë 9 kredite.</p> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani mësimor i programi bachelor në infermeri;</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi Bachelor në Infermieri është ngritur fillimisht nën kujdesin dhe modelin e infermierisë në IAL publike, më vonë është përditësuar me programet e Universitetit të Foggias, Universitetin e Salernos dhe “I.Qemali” në Vlorë. Struktura e lëndëve përbëjnë drejtimet kryesore të shërbimeve shëndetësore: klinike dhe kujdesi ndaj pacientit. Kujdesi infermioror ndaj pacientëve të patologjive të ndryshme është pjesë e programit mësimor. Raporti teori praktikë është mbi 50% në favor të praktikave profesionale. Infermieristika I+II ka 76 orë mësimore dhe 92 orë praktika laboratorike, ndërsa ën vitin e II dhe të III praktikat përbëjnë 50% të orëve në auditor.</p> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani mësimor i programi bachelor në infermeri;</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të</p>	<p>Struktura e programit është në funksion të objektivave të përcaktuara në rregulloren e programit Bachelor në Infermieri të Kolegjit Universitar “REALD”. Veprimtaritë formuese të programit mësimor janë ndarë në 50% leksione teorike dhe 50% formim praktik , të përbërë prej laboratorëve , seminareve , praktikave , projekte kursi. Struktura e programit mësimor me lëndë, veprimtari mësimore dhe kredite e ngjashme me</p>

studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>programe të tjera bachelor në infermieri në fakultete të tjera, bën të mundur transferimin e studentëve, mobilitetin, kalimin e provimit të licencës dhe punësim.</p> <p><i>Evidenca nr. 7. Rregullore e programit Ba. në Infermieri-miraturar me Vendim nr. 5 dt. 25.02.2022 te SA;</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Përditësimi i sylabuseve sipas dokumentave është bërë në mënyrë periodike, edhe si pasojë e organizimeve dhe riorganizimeve të programeve në bashkëpunim me institucione mësimore vendase dhe të huaja, si Universiteti i Foggias, Salernitanes, Vlorës.</p> <p>Kjo ka bërë që sylabuset të jenë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Rishikimi në masën mbi 20% ka ndodhur në vitin 2021 me Vendim nr. 41 datë 24.09.2021 të Senatit Akademik.</p> <p><i>Evidenca nr.35 . Vendim i Senatit Akademik nr. 41 datë 24.09.2021 për riorganizimin në masën mbi 20% të programit të studimit bachelor në infermieri;</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Infermieri ofruar nga Kolegji, bazuar në objektivat e programit të studimit, synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e infermieristikës: njohuri të avancuar në fushën e infermierisë, aftësi praktike, përgjegjësi individuale dhe për të tjerët. Lëndët pjesë e programit mbulojnë spektrin: formimin bazë shëndetësor/ paraklinik, formim specifik infermieror, formimin klinik, formin miks- kujdes infermieror dhe klinik.</p> <p><i>Evidenca nr.47 . Program mësimor bachelor nw Infermieri 2020-2023;</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Struktura mësimore e programit bachelor në infermieri, i jep mundësi studentëve që të vazhdojnë Master Profesional të specialiteteve të ndryshme (Infermieri patologjike, kirurgjikale, menaxhim infermieror, etj). Vazhdimi i studimeve në nivelin e dytë, ju krijon mundësinë që të punësohen bazuar në nevojat e tregut të punës dhe shërbimeve shëndetësore.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit Bachelor në Infermieri është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit 6 sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Kolegji Univeristar “REALD” ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin “I.Qemali” në Vlorë, Universitetin e Salernos, spitalin rajonal Vlorë, pjesë e marrëveshjes është edhe konsultimi për përmirësimin e përmbajtjes së programeve dhe përshtatjes me kërkesat e tregut të punës. Rezultat i këtyre propozimeve ka qenë edhe organizimi dhe riorganizimi i programit të Bachelor në Infermieri, me Vendim nr. 41 datë 24.09.2021 të Senatit Akademik.</p> <p><i>Evidenca nr. 28-29. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Salernos, Itali dhe “Ismail Qemali”, Vlorë;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka në strukturën e tij Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, e cila ndjek ecurinë e punësimit të studentëve të diplomuar në KUR, por edhe mbedh mendime për përmirësimin e programit.</p> <p><i>Evidenca nr. 15. Rregullore e Keshillimit te Karrieres;</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete</p>	<p>Departamenti Shkencave Teknike Mjeksore si njësi përgjegjëse për programin Bachelor në Infermieri, në bashkëpunim me institucionet mësimore (universiteti Vlorës, Salernos), strukturat ofruese të kujdesit shëndetësor (spitali rajonal Vlorë, Fier) si dhe Urdhëri i Infermierit, diskuton trendin në fushën e infermierisë dhe punësimit të tyre, dhe si të përmirësojnë programet e studimit.</p>

profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.									
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar "REALD" nxit përfshirjen e studentëve dhe IAL me të cilët ka marrëveshje, si dhe institucionet e kujdesit shëndetësor (spital, poliklinikë), në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Programi i studimeve Bachelor në Infermieri organizuar nga Kolegji Universitar "Reald" është bazuar në programin mësimor të miratuar me Vendim nr. 41, datë 24.09.2020 të Senatit Akademik, dhe miratuar me Urdhër Nr. 257 datë 19.07.2021, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.</p> <p>Në këtë program mësimor janë përshkruar të gjitha format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, si janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura.</p> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani mësimor i programit bachelor në infermieri;</i></p>

<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në programin mësimor të miratuar me Vendim nr. 41, datë 24.09.2020 të Senatit Akdemik, dhe miratuar me Urdhër Nr. 257 datë 19.07.2021, të Minitarit të Arsimit dhe Sportit, personeli akademik, ofron metoda të ndryshme të mësimdhënies, mësimnxënies. Përvec këtyre metodave, personeli akademik në bashkepunim me Departamentin përkatës ju kanë ofruar studentëve leksione të hapura dhe konferenca shkencore, duke ju dhënë studentëve mundësi alternative të mësimnxënies. Po kështu edhe studentët u shprehën pozitivisht për procesin mësimor duke konfirmuar ekzistencën e formave dhe mënyrave të ndryshme alternative të mësimin, sidomos formave të reja të mundësuar edhe me ndihmën e teknologjisë dhe aksesit në bibliotekat mësimore online.</p> <p><i>Evidenca nr. 47. Programi mësimor Bachelor në Infermieri 2020-2023;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.</p>	<p>Kolegji Universitar “Reald” mbështet personelin jo vetëm me infrastrukturën përkatëse për ofrimin e metodave klasike të mësimdhënies (leksione, seminare, laboratorë, praktika), por edhe me metoda inovative të mësimdhënies/mësimnxënies në distancë, si: Google Classroom për studentët dhe stafin akademik, programin OBS për regjistrimin Video dhe Audio , të leksioneve dhe seminareve, që ju shpërndahet studentëve dhe personelit akademik. Në planin buxhetor të përvitshëm, KUR parashikon fonde për kërkimin shkencor dhe pasurimin e metodave të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca nr. 32. Vendim i Bordit Administrimit nr.2 datë 15.02.2022 për miratim fondi për kërkim shkencor për vitin akademik 2022-2023 në KUR;</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p>	<p>Kopetenca profesionale dhe pedagogjike e stafit akademik të punësuar pranë KUR sigurohet fillimisht te kriteret në punësim, bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, specializimin përkatës dhe eksperiencën profesionale. Stafi pedagogjik ka Curriculum Vitae të përshtatshme për të qenë kopetentë në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, gjithashtu, stafi është i aftë të përdorë metoda të ndryshme të mësimdhënies, si dhe nxisë studentët drejt diskutimeve krijuese me qëllim rritjen e autonomisë së marrjes së vendimeve profesionale nga ana e tij. Diskutimi i rasteve klinike është një nga metodat që nxit të mësuarin kritik dhe rrit aftësinë e vendimmarrjes.</p>

<p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Në KUR funksionon Këshilli Studentor, i cili ka përfaqësuesit e tij në Senat, por gjithashtu është një aktor i rëndësishëm për ngritjen e zërit të studentëve në lidhje me kërkesat e tyre. KUR dhe Këshilli Studentor bashkëpunojnë dhe në mënyrë periodike përmes pyetësorëve, vlerësojnë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies, si dhe ti reflektojnë ato në përmirësimin e metodologjisë. Rezultatet e anketimit janë paraqitur në Raportin vjetor 2021 -2022 të NJSBC, Nr. 272 Prot. <i>Evidenca nr. 89.Raport vjetor për NJSBC 2020-2021;</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>KUR ka ngritur me Vendim Nr. 11 datë 15.10.2021 të Senatit Akdemik “Strukturën e sigurimit të cilësisë dhe këshillimit të karrierës” i cili është institucioni që koordinon punën midis njësive kryesore dhe ature bazë, për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. NJSBC përmes metodave të ndryshme, duke përfshirë edhe anketimin e studentëve, bën të mundur që procesi i përmirësimit të përfshij edhe mendimn e palëve per të cilët ekziston KUR, që janë studentët. Me qëllim eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja në mësimdhënie, KUR ka ngritur edhe Qendrën Kërkimore Shkencore, e cila përgatit plane vjeotre për aktivitetin e saj (plani vjetor 2021-2022), dhe mbështet me buxhetin përkatës nga institucioni.</p> <p><i>Evidenca nr. 14. Rregullore e NJSBC miratuar me Vendim nr.19 datë 01.08.2017 të Senatit Akademik;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kolegji Universitar “REALD” garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e</i></p>






	rezultateve. Ky proces mbështetet dhe bazohet në rregulloren e NJSBC.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>KUR ka një bazë rregullatore të mirëorganizuar në lidhje me mënyrat dhe testimin e njohurive , dijeve dhe aftësive profesionale, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Kolegjit Universitar “REALD”, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, - Rregullore e FSHMT miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik; - Rregullore e zhvillimit të provimeve, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik; - Rregullore e diplomimit të studentëve miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik; <p>Këto vendime janë publike në websitin e Kolegjit dhe ju bëhen të ditur studentëve në fillim e cdo viti akademik.</p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në takimin e organizuar me studentët e programit Msc në Stomatologji të KUR, theksojmë që në fillimin e cdo lënde apo moduli, ata informohen nga pedagogu i lëndës, për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Zakonisht ora e parë e çdo lënde rezervohej për prezantimin e detajuar nga ana e titullarit të lëndës të përmbajtjes së lëndës / modulit dhe detyrimeve të studentëve. Programet lëndore vendosen gjithashtu në dispozicion të studentëve që në fillim të semestrit nëpërmjet kanaleve të brendshme të komunikimit student / pedagog në klasat e menaxhuara në platformën e menaxhimit të mësimi dhe nëpërmjet emailit institucional me të cilin ishte i pajisur çdo student.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Bazuar në rregulloret si më poshtë:


<p>profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e Kolegjit Universitar “REALD”, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, - Rregullore e FSHMT miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik - Rregullore e zhvillimit të provimeve, miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik - Rregullore e diplomimit të studentëve miratuar me Vendim nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik; <p>në programin e studimit Bachelor në Infermieri përdoren metoda të ndryshme të testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Metodatat e përdorura janë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - provim me shkrim (pyetje shtjelluese ose me opsione); - pyetje me goje; - detyra kursi; - demonstrim teknikash; - vlerësim me shkrim i udhëheqësit të praktikave; - provim me shkrim formues ose temë diplome;
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Njësia bazë në bashkëpunim me NJSBC, kryejnë anketime me studentët, gjetjet e të cilit përdoren për përmirësimin e cilësisë dhe larmisë së metodave të mësimdhënies. Rezultatet e anketimit janë paraqitur në Raportin vjetor 2021 -2022 të NJSBC, Nr. 272 Prot.</p> <p><i>Evidenca nr. 89.Raport vjetor për NJSBC 2020-2021;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Infermieri ka objektivat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të menduarit kritik në gjykimet dhe vendim-marrjet profesionale; - Të mësuarit e bazuar në problem; - Komunikimin efektiv me të tjerët; - Kontribuimin në rritjen e kapaciteteve shëndetësore komunitare; <p>Me qëllim realizimin e këtyre objektiveve, përdoren metodat mësimdhënies dhe formimit profesional, si më poshtë: leksione, seminare, laboratore, praktika mësimore dhe profesionale, diskutimi i rasteve klinike, praktikimi në emulazhe, konferenca shkencore, leksione të hapura, të cilat kanë si qëllim rritjen e dijeve dhe aftësive profesionale të</p>

dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	studentit, që i mundësojnë studentit mendim kritik dhe zhvillim autonomie profesionale.			
Konkluzione	<i>KUR ka të hartuar "Rregulloren e programit të studimit "Bachelor" në "Infermieri", miratuar me Vendim nr. 5, datë 25.05.2022 të Senatit Akademik, të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore si dhe garanton zbatimin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në syllabuset e lëndëve dhe Rregulloren e Përgjithshme të KUR, është parashikuar testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale gjatë gjithë vitit akademik. Në syllabusin e lëndës vlerësimi i vazhdueshëm përbën 30% të pikëve në vlerësimin përfundimtar të studentit. <i>Evidenca nr. 50. Syllabuset;</i> <i>Evidenca nr. 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL;</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	KUR ka në zbatim mënyra të ndryshme për të shmangur forma të ndryshme abuzimi dhe për të rritur transparencën. Institucioni ka system elektronik testimi dhe vlerësimi për testin e hyrejs së studentëve në programin e studimit. Gjithashtu, gjatë pandemisë, institucioni ka përdorur testimin on-line. Ku testi ju dërgohej në formë linku, dhe student e plotësonte nën mbikqyrje të komisionit të provimit on-line. Për testimin e lëndëve, provimet kryhen në salla të mbikqyrura nga kamera, që redukton mundësinë e kopjimit, dhe rezultatet jepen brenda 3 ditëve nga kryeja e provimit.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet nga pedagogu lector, nën mbikqyrjen e titullarit të lëndës, dhe teza e përgatitur prej tij

<p>bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>firmoset nga Drejtuesi i Departamentit. Provimi bëhet me gojë përballë një komisioni prej 3 vetash, ose me shkrim nga një komision prej 2 vetash. Përmbajtja e tezës bazohet në syllabusin e lëndës të dhënë gjatë viti akademik, dhe përban gjithë elementët informues të kërkuara nga baza ligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Pedagogët ju mundësojnë studentëve që të marrin feedback për performance e tyre gjatë provimit. Në provimet me gojë, këto këshilla jepen direkt. Në provimet me shkrim, këshillat jepen ndaj studentëve të cilët dëshirojnë të shikojnë tezën dhe vlerësimin që kanë marrë.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Njësia përgjegjëse dhe KUR kanë përgatitur Rregullore për përgatitjen e temës së diplomës, si dhe Rregulloren e zhvillimit të provimeve, të cilat shmangin mundësinë e plagjiaturës dhe të kopjimit. Edhe në syllabuset e lëndëve shprehet qartë kërkesa për integritet akademik dhe shmangie të plagjiaturës. Provimet kryhen në salla me kamera me qëllim shmangien e kopjimit nga studentët.</p> <p><i>Evidenca nr. 8. Rregullore për zhvillimin e provimeve;</i></p> <p><i>Evidenca nr.9. Rregullore e diplomimit të studentëve;</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e testeve apo vlerësimit të kopetencave profesionale bëhen bazuar në meritën e studentit, dhe sipas Rregullores së Përgjithshme të Kolegjit, Neni 58, rezultatet e provimeve jepen brenda 3 ditëve nga kryerja e provimit. 1 ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve, dhe printohet procesverbali, i cili firmoset nga lektori dhe depozitohet në sekretari dhe department.</p> <p><i>Evidenca nr. 4. Rregullore "Rregullore e përgjithshme e IAL KUR;</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut,</p>	<p>Sipas Rregullores së Përgjithshme të Kolegjit, Neni 58, institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit. 1 ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve. Në rast paqartësisht, studenti ka të drejtë të shikojë provimin në prezencën e pedagogut. Për sqarime të mëtejshme student i drejtohet me shkrim Shefit të Departamentit që mbulon lëndën përkatëse.</p>




<p>rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p><i>Evidenca nr. 4. Rregullore "Rregullore e përgjithshme e IAL KUR;</i></p> <p>Institucioni ka të sanksionuar në kuadrin rregullator të tij: Rregullore e përgjithshme e KUR, Rregullore e FSHM, Rregullore e zhvillimit të provimeve, Rregullore e Diplomimit; që cdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Sipas kuadrit rregullator, 1 ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve. Në rast paqartësisht, studenti ka të drejtë të shikojë provimin në prezencën e pedagogut. Për sqarime të mëtejshme studenti i drejtohet me shkrim Shefit të Departamentit që mbulon lëndën përkatëse. Në pamundësi të zgjidhjes së ankesës, Shefi Departamentit vë në dijeni Dekanin, i cili brenda 48 orësh nga marrja dijeni e ankesës, ngre një komision ad hoc prej 3 anëtarësh, i cili verifikon pretendimet e studentit duke vlerësuar tezën e provimit me shkrim. Në rast se provimi është dhënë me gojë, studenti e përsërit provimin në prani të komisionit ad hoc, duke tërhequr një tezë të dytë. Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të studentit. Ndryshimi i notës pasqyrohet në procesverbalin e ri të firmosur nga komisioni ad hoc, dhe i bashkangjitet procesverbalit të mëparshëm.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka kuadër rregullator që siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet bazuar në programin e parashikuar në syllabusin e lëndës, dhe kryhet bazuar në rregulloren e programit të studimit. KUR ka në vendosur sistemin e kamerave mbikqyrëse në sallat ku kryhen provimet. Kjo shmang mundësinë e abuzimit dhe të kopjimit. Tezat kontrollohen nga Shefi Departamentit dhe janë përgjegjësi e Pedagogut të lëndës, Përgjigjet jepen brenda 3 ditëve.</i></p> <p><u><i>Sugjerohet që institucioni të mundësojë sekretimin e provimeve me qëllim kryerjen e korrigjimeve "blind", duke rritur vlerësimin bazuar në meritë.</i></u></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.4





Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Cikli i parë i studimeve Bachelor në Infermieri organizuar nga Kolegji Universitar “Reald” është bazuar në programin mësimor të miratuar me Vendim nr. 41, datë 24.09.2020 të Senatit Akademik, dhe miratuar me Urdhër Nr. 257 datë 19.07.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Në këtë program mësimor janë përshkruar të gjitha format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, që garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi mësimor i miratuar me Vendim nr. 41, datë 24.09.2020 të Senatit Akademik, dhe miratuar me Urdhër Nr. 257 datë 19.07.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, përmes lëndëve: Informatikë, Psikologji, Legjislacion, Deontologji. <i>Evidenca nr. 49. Plani bachelor në infermieri viti akademik 2021-2024;</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Cdo titullar lënde ka përcaktuar në syllabusin e lëndës kompetencat dhe aftësitë që do të fitojë në përfundim të lëndës. Pedagogu i lëndës, gjatë zhvillimit të leksioneve, seminareve, praktikave mësimore, orienton studentët për çështjet më të rëndësishme, si dhe detyrimet përmbyllëse që ai ka kundrejt plotësimit të programit. Detyrimet e studentit janë: pjesmarrja në leksione, seminare, praktika, kryerja e detyrave të kursit, provimeve. Plotësimi i detyrimeve, bën të mundur që studenti të fitojë kompetencat dhe aftësitë përkatëse në përfundim të lëndës. <i>Evidenca nr. 53-57. Syllabuset Infermieri;</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet	Programi i studimit Bachelor në Infermieri ka si qëllim që të formojë profesionistë të fushës infermieristike, me kompetenca profesionale. Plani mësimor, ku përfshihen përvec leksioneve dhe seminareve, edhe praktika mësimore e profesionale, laboratorë, është i hartuar për të formuar profesionistë të aftë për të ofruar shërbim infermior në mënyrë të pavaruar. Për këtë qëllim, në planin mësimor janë parashikuar praktika profesionale në institucionet e kujdesit

diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.	shëndetësor, 17 kredite. Por, praktikat janë të paraprirë nga leksione të dhëna nga specialistët përkatës të lëndës, bazuar në kompetencat profesionale të tyre, si dhe të shoqëruara me raste klinike, zgjidhjen e tyre dhe rolin e infermierit si profesionist i kujdesit shëndetësor ndaj këtyre rasteve.			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Cdo fillim viti akademik, Qendra Kërkimore Shkencore përgatit planin vjetor të aktiviteteve shkencore, i cili miratohet nga Senati Akademik, dhe përgatitet në bashkëpunim me personelin akademik afektiv dhe me kontratë, ku përfshihen leksione të hapura, prezantimi i studimeve shkencore dhe njohja me të reja më të fundit të shkencës.			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar REALD ka strukturë të posaçme në nivel institucional, që promovon rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit, si NJSBC dhe Qendra Kërkimore Shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit	Kolegji Universitar “REALD” ka miratuar me Vendim Senati Nr.5 datë 25.05.2022 “Rregulloren e studimit në Bsc Infermieri, e ndryshuar”, ku në <i>Kreun IV, Diplomi, Neni 19</i> , “Modalitetet për mbrojtjen e diplomës”, janë përcaktuar qartë rregullat për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Pragu i notës mesatare që i jep të drejtën

<p>të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>studentit për punim diplome është 8 (tetë) e sipër, dhe është publike në webpage të KUR.</p> <p><i>Evidenca nr. 7. Rregulloren e programit bachelor në infermieri;</i> <i>Evidenca nr. 8. Rregullorja e diplomimit të studentëve;</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>KUR me Vendim Senati Nr.5 datë 25.05.2022 “Rregulloren e studimit ne Bsc Infermieri, e ndryshuar”, ku në Kreun IV , Diplomimi, Neni 20, “ Mbrojtja e diplomës me provim formues të përgjithshëm”, përcakton qartë detyrat e departamentit për të përcaktuar lëndët që do të përfshihen në provim, dhe titullarët e lëndëve dorëzojnë në department temat e përzgjedhura ëpr secilën lëndë, nga do të nxirren pyetjet e provimit. Lista e temave mësimore vihet në dispozicion të studentëve 2 muaj para sezonit të diplomës. Studentët informohen 2 muaj para provimit për formën e vlerësimit të njohurive.</p> <p><i>Evidenca nr. 8. Rregullorja e diplomimit të studentëve;</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Drejtuesi i departamentit përgatit tezën e provimit nga banka e pyetjeve për cdo lëndë, ku përfshihen lëndët e formimit karakterizues dhe me zgjedhje. Kjo bën të mundur testimin e njohurive të dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> <p><i>Evidenca nr. 8. Rregullorja e diplomimit të studentëve;</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i</p>	<p>KUR me Vendim Senati Nr.5 datë 25.05.2022 “Rregulloren e studimit ne Bsc Infermieri, e ndryshuar”, ku në Kreun IV , Diplomimi, Neni 21, “ Mbrojtja e diplomës me punim teme”, përcakton qartë procedurat e përgatitjes: studenti në konsultim me një pedagog , bëhte udhëheqës i tij pasi firmoset nga Dekani i Fakultetit. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas “Rregullores së studimit në Bsc Infermieri e ndryshuar”. Tema e diplomës dorëzohet 2 (dy) javë përpara mbrojtjes, pasi ka marrë miratimin e udhëheqësit.</p> <p><i>Neni 22, Udhëheqësi i diplomës;</i> <i>Evidenca nr. 8. Rregullorja e diplomimit të studentëve;</i></p>

plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Departamenti dhe Udhëheqësi i temës, bazuar në “Rregulloren e studimit në bachelor infermieri, të ndryshur” dhe “Udhëzuesin për hartimin e punimit të diplomës”, asistojnë studentin në për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij, bazuar në temën e përzgjedhur apo të dhënat që nevojiten . <i>Evidenca nr. 8. Rregullorja e diplomimit të studentëve;</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Bazuar në “Rregulloren e përgjithshme të KUR”, “Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjeksore”, “ Rregulloren e programit të studimit Bsc Infermieri”, i ndryshuar”, në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	KUR me Vendim Senati Nr.5 datë 25.05.2022 “Rregulloren e studimit ne Bsc Infermieri, e ndryshuar 2, ku në <i>Kreun IV , Diplomimi, Neni 23</i> , “ Modalitetet e marrjes së diplomës”, përcakton qartë procedurën që në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Kolegji Universitar “Reald” ruan kopje të dokumentacionit të studentit në përputhje me legjislacionin e përcaktuar, i cili u verifikua në sekretari gjatë vizitës. Informacioni ruhej në regjistrat e furnizuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar “Reald” ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. KUR ka miratuar me Vendim Senati Nr.5 datë 25.05.2022 “Rregulloren e studimit ne Bsc Infermieri, e ndryshuar”, ku në <i>Kreun IV , Diplomi, Neni 19</i>, “Modalitetet për mbrojtjen e diplomës”, janë përcaktuar qartë rregullat për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Pragu i notës mesatare</i>




	që i jep të drejtën studentit për punim diplome është 8 (tetë) e sipër, dhe është publike në webpage të KUR. KUR me Vendim Senati Nr.5 datë 25.05.2022 "Rregulloren e studimit ne Bsc Infermieri, e ndryshuar2 , ku në Kreun IV , Diplomimi, Neni 23, " Modalitetet e marrjes së diplomës", përcakton qartë procedurën që në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

IV. LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin	<p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit përbëhet nga pedagogë me eksperiencë dhe përgjithësisht kualifikimin e duhur profesional në fushat përkatëse që ata zhvillojnë në program. Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, referuar listës së stafit akademik të angazhuar në këtë program, janë angazhuar staf akademik për tre vite akademike si më poshtë vijon: (Tabele përmbledhëse: ngarkesa e orëve në auditor për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit "Bachelor" në "Infermieri", për vitet 2020-2021, 2021-2022 dhe 2022-2023)</p> <ol style="list-style-type: none"> Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 19 pedagogë nga të cilët 13 PAE dhe 6 PAK (68 % /32 %), (tabela përmbledhëse) Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 19 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 8 PAK (60 % / 40 %), (tabela përmbledhëse)

e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 20 pedagogë nga të cilët 12 PAE dhe 8 PAK (56 % / 44 %):, (tabela permbledhese)

Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	-	1	-	1	-	1
Dr/PhD	3	3	2	1	3	1
Msc	10	2	9	6	9	6
Në total	13	6	11	8	12	8

Sikundër shihet në këto të dhëna, ka një shpërndarje jo të rregull të ngarkesës sipas ndarjes PAE/PAK.

GVJ konstatoi se ka pedagogë që formimi i tyre profesional nuk përputhet me lëndët që ata zhvillojnë. Kështu pedagogë me formim biologji zhvillojnë lëndë mjekësore si imunologji, mikrobiologji mjekësore, biokimi mjekësore. Ka pedagogë që janë me titull akademik MSc që janë drejtues lëndës/modulesh. Nga ana tjetër raporti i plotësimit të 70% të ngarkesës me staf të brendshëm, mbetet përsëri problematike. Kjo vjen nga fakti që mosrekrutimi i personelit të kualifikuar në fushën e duhur por që angazhohet kryesisht me kontratë.

Pavarësisht përpjekjeve të bëra nga ana e institucionit, është evidente mungesa e personelit të profilizuar në lëndët e formimit bazë dhe specifik.



GVJ rekomandon që Institucioni duhet të vazhdojë përpjekjet për rekrutimin e personelit të specializuar në fushën e infemierisë për të përmbushur detyrimet ligjore dhe standartet e cilësisë.

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.


Nga shqyrtimi i dokumentacionit të marrë gjatë vizitës në institucion (*Ngarkesa e orëve në auditor për stafin akademik Bachelor Inferimieri 2020-2021 deri ne vitin 2022-2023*), u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për tre vite akademike është si më poshtë vijon:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2020-2021	504	264	240	52% / 48 %
2021-2022	2088	1524	564	72% / 28%
2022-2023	2112	1416	696	67% / 33%



	<p>Nga tabela rezulton që për 2 vite akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, nuk është përballuar me <u>mbi</u> 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit. (Tabele përmbledhëse: ngarkesa e orëve në auditor për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit “Bachelor” në “Infermieri”, për vitet 2020-2021, 2021-2022 dhe 2022-2023)</p> <p><u>GVJ rekomandon</u> që përballimi i ngarkesës mësimore të PS Bachelor “Infermieri” të realizohet në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar.</p> <p>(Ngarkesa e orëve në auditor për stafin akademik Bachelor Infermieri 2020-2021 deri ne vitin 2022-2023),</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit Bsc në Infermieri, gjatë 3 viteve të fundit nuk ka ndryshuar, pra ka patur qëndrueshmëri. Kjo vërehet në listën e PAE të tre viteve të fundit, por edhe në kontratat e punës të lidhura midis PAE dhe administratorit të Kolegjit Universitar “REALD”.</p> <p><i>Lista e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit Bachelor ne Infermieri - Viti akademik 2021-2022;</i></p> <p><i>Lista e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit Bachelor ne Infermieri - ne 3 vitet e fundit;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” ndjek procedurë rekrutimi të mirëpërcaktuar në “Rregulloren e zyrës së burimeve njerëzore” të miratuar me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademi. Në nenin 31, përcaktohet qartë procedura e punësimit, që nga kërkesa për personel akademik efektiv nga njësia bazë drejt njësisë kryesore, andej drejt Rektorit.</p> <p><i>Praktike rekrutimi e stafit akademik - viti akademik 2022-2023</i></p> <p>Kërkesat për punësim miratohen nga Senati Akademi dhe Bordi Administrimit, pastaj lajmërimi bëhet publik. Administratori i kolegjit ngre komisionin ad-hoc për përzgjedhjen e personelit akademik. Në kërkesat për punësim, përcaktohen edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me kualifikimin profesional dhe akademik. Pavaresisht sistemit te rekrutimit, institucioni rezulton të mos ketë prurje të reja në staf të kualifikuar në fushën</p>

	<p>repsektive. Kjo kërkon modalitete të reja për të qënë atraktiv dhe për të punësuar personel të ri.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” ka vendosur në dispozicion të kryerjes së programit mësimor BSc në Infermieri laboratorë të ndryshëm profesional dhe salla leksionesh, të cilët mirëmbahen nga personel ndihmës akademik të përshtatshëm.</p> <p>Personeli i angazhuar është kryesisht i punësuar në spitalin e Vlorës të cilët zotërojnë eksperiencë të gjatë klinike. Në këtë kontekst angazhimi i personelit ndihmës akademik me eksperiencë për realizimin e orëve laboratorike dhe praktikave klinike konsiderohet pozitiv.</p> <p><i>Marreveshja e bashkepunimit me Spitalin Rajonal te Vlores;</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Kolegji Universitar “Reald” mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit Bsc në Infermieri. Në tabelat përmbledhëse 2,4, 5, si dhe në dosjet e vëzhguara fizikisht në institucion, të dhënat përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrative.</p> <p>Të dhënat ruhen në letër dhe në formë statistikore. Nga ana tjetër, GVJ nuk evidentoi mekanizma të vlerësimit të performancës në kuadër të promovimit të personelit akademik.</p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni të vazhdojë të fuqizojë mekanizmat e sigurimit të cilësisë në kuadër të përmirësimit të saj si dhe promovimit të personelit akademik.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e</p>	<p>Institucioni, për realizimin e praktikës profesionale dhe temave të diplomave të studentëve dhe veprimtarive të tjera kërkimore shkencore, ka nënshkruar një sërë kontratash me institucione arsimore dhe shëndetësore publike dhe private.</p> <p><i>marrëveshjet me institucione vendase dhe të huaj;</i></p> <p>Lista e institucioneve partnere të vëna në dispozicion për personelin dhe studentët konsiderohet mjaft pozitive nga GVJ.</p>






<p>mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Ajo ndihmon të realizohen praktikat profesionale, punimin e diplomave dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>		
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Nga informacionet e vëna në dispozicion në Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore është angazhuar dhe një staf ndimës akademik me master profesional për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, por referuar infrastrukturës dhe gjendjes së tyre, rezulton që institucioni kujdeset për infrastrukturën laboratorike dhe e mban atë në funksion të procesit mësimor.</p> <p><i>(vizita e ambienteve)</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Personeli akademik efektiv dhe më kontratë që mbulon programin e studimit BSc në Infermieri, përmbush kërkesat ligjore të kornizës rregullatore për IAL përsa i përket numrit dhe kualifikimit, por ata nuk kanë fushën e duhur profesionale në përputhje me fushën e programit, lëndën apo praktikën profesionale që do të mbikqyrë, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i></p> <p><i><u>GVJ sugjeron që institucioni të vazhdojë të fuqizojë mekanizmat e sigurimit të cilësisë në kuadër të përmirësimit të saj si dhe promovimit të personelit akademik.</u></i></p> <p><i>Ngarkesa mësimore për këtë program studimi, nuk është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë në përputhje me aktet ligjore.</i></p> <p><i><u>GVJ rekomandon që përballimi i ngarkesës mësimore të PS Bachelor “Infermieri” të realizohet në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar.</u></i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, biblioteka, shërbimet për studentët, janë të përshtatshme për zhvillimin e një procesi normal mësimor. Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimorë, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme në ambiente të tjera dhe parking.</p> <p>Institucioni disponon sistem ngrohje-ftohje qendrore, sistem sigurimi pa ndërprerje të energjisë elektrike, nyje hidrosanitare, sistem të mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ vizitoi auditorët mësimorë të cilat ishin të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim. Këtë vit akademik institucioni ka zgjeruar kapacitetin pritës me ambiente të reja (kati -1) në të njëjtën godinë.</p> <p>Mjediset mësimore janë të pajisura me mjetet elektronike dhe teknologjisë së informacionit, që ndihmojnë në realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik. Sallat e leksionit janë të pajisura me projektorë që mundëson demonstrimin më video të leksioneve të ndryshme. Personeli akademik ka kompjuter personal me lidhje internet, që bën të mundur edhe zbatimin e metodave të mësimdhënies në distancë përmes google classroom. KUR ka vënë në dispozicion të procesit mësimor 2 laboratorë dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e programit të studimeve. (vizita në ambiente).</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo</p>	<p>Institucioni disponon laboratorë mësimorë mjekësore dhe kabinete në funksion direkt të zhvillimit normal të programit</p>






<p>mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>mësimor, si kabineti i fizioterapisë, i infermierisë, laboratorit i anatomisë, fizikës, informatikës dhe kimisë. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me video projektor dhe me pajisjet e tjera të nevojshme. <i>(vizita e ambienteve).</i></p> <p>Laboratorët mësimorë përmbajnë aparaturat dhe mjetet e tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit. Laboratori i infermierisë dhe i mamisë ndihmon studentët që të mësojnë të mësojnë praktikat klinike dhe raste duke simuluar raste të ndryshme të urgjencës, ndihmës së shpejtë, shërbimit mjekësor etj.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka të instaluar një laborator informatike të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale në përputhje me programin e studimit. Për kryerjen e orëve të praktikës profesionale sipas programit të studimit KUR ka në zbatim marrëveshje bashkëpunimi me institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor.</p> <p><i>Nga sa më sipër, <u>GVJ sugjeron</u> përmirësimin e kapaciteteve infrastrukturore dhe logjistike në funksion të programit të studimit për realizimin e procesit të mësimdhënies.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kolegji Univeristar “Reald” vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme, për realizimin e procesit mësimdhënës, si dhe të programit të formimit praktik, në bashkëpunim me IAL dhe klinika private, përtej faktit që ka edhe 2 laboratorë në ambjentet e tij.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>



Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” ka në bibliotekën e tij 153 tituj librash fizikë në fushën e shkencave mjeksore, dhe një listë e gjatë tituj librash të aksesueshëm në bibliotekën on-line në platformën freebooks4doctors. Studentët i marrin leksionet në formë elektronike ose të printuara, kanë libra</p>


<p>marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>në gjuhën shqipe apo të huaj. Në fund të çdo syllabusi studentit gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojnë në gjuhën shqipe apo të huaj që i përgjigjet temave të programit mësimor. <i>Evidenca nr. 50. Syllabuset;</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Në rregulloren e NJSBC është e përcaktuar që cdo fillim viti njësia bazë përgjegjëse për programin mësimor përditëson literaturën mbi të cilën përgatietet syllabusi dhe zhvillohet lënda. <i>Evidenca nr. 14. Rregullore e NJSBC;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në ambientet e Bibliotekës të Kolegjit Universitar “REALD” u konstatua se është në dispozicion dhe aksesohet nga cdo student sipas nevojës. Biblioteka disponon rreth 20 vende leximi dhe vende interneti të pajisura me kompjutera. Biblioteka disponon 2500 botime/titujsh librash profesional. Stafi akademik dhe studentët dispononin adresa të brendshme email-i. (në formë elektronike apo në letër).</p> <p><i>Evidenca nr. 12. Rregullore e standartizimit të procedurave për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentave;</i></p> <p><i>Rregullore e standardizimit të procedurave për hartimin, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit zyrtar;</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit. <i>Lista e librave në fushën e shkencave mjekësore që ndodhen në Bibliotekën e IAL;</i></p> <p>Në bibliotekë arkivohen kopjet e revistës së botuar nga ana e institucionit dhe periodikë të tjerë (<i>vizita e ambienteve</i>).</p> <p>Biblioteka është e pajisur me poste leximi me akses në internet të cilët i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës bazë ose ndihmëse në funksion të programit të studimit. Megjithatë biblioteka ka fond të limituar në tekste mësimore bazë, në gjuhën shqipe të viteve të fundit, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha lëndëve të programit të studimit. Aksesit në libraritë online është mundësi për shfrytëzimin e e botimeve të reja nga stafi dhe studentët.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online</p>	<p>Kolegji Universitar “Reald” ka Bibliotekë në ambientet e tij, dhe ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë, për studentët e Bsc në Infermieri në bibliotekën online në platformën www.freebooks4doctors.com www.freemedicaljournals.com .</p>



të fushës së programit të studimit.	
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Në bibliotekë ka programe kompjuterike dhe internet, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët të literaturës në të dhe online. <i>Biblioteka on-line, lista e librave të disponueshëm në bibliotekën e KUR;</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara dhe janë në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Biblioteka është e hapur cdo ditë nga 8.00 deri në orën 16.00. Institucioni nuk ka punonjës të veçantë për bibliotekën.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka monitoron fondin e librave fizikë të bibliotekës, si dhe fondin e borimeve në platformën on-line www.freebooks4doctors.com , të cilat pasurohen në mënyrë periodike bazuar në kërkesat e personelit akademik dhe njësive kryesore. Bazuar në deklaratimet e studentëve dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, ata shprehen pozitivisht për ndihmen dhe mbështetjen e stafit akademik në sigurimin e teksteve, leksione apo literature ndihmese që ju nevojitet gjatë vitit akademik. <i>(takimi me studentët)</i> . Pavarësisht aksesit të siguar, dhe kënaqshmërisë së studentëve, <i>institucioni duhet të krijojë kushte për akses të bibliotekat on-line të fushës së mjekësisë të cilës i përket dhe programi i studimit.</i> <i>Lista e librave në fushën e shkencave mjekësore që ndodhen në Bibliotekën e IAL;</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bsc në Infermieri përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar, fond fizik por edhe akses në platformën www.freebooks4doctors.com, www.freemedicaljournals.com, në mbështetje të mësimdhënies. Gjithashtu, KUR ka bibliotekën e tij, që</i>

	<p><i>përdoret nga studentët në orarin e mësimdhënies, dhe pa kufizim ndaj titujve shkencorë.</i></p> <p><i>Sugjerohet që të ketë evidencë më të plotë të përdorimit të bibliotekës dhe titujve të librave sipas programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” ka sistem menaxhimi të brendshëm për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. KUR ka një database elektronike ku mbahet gjithë informacioni për studentin, si dhe regjistri themeltar sipas formatit të miratuar nga MAS. Në dokumentacionin mbështetës, institucioni ka paraqitur një dokument i cili tregon mekanizmat e ruajtjes dhe administrimit të informacionit në KUR lidhur me studentët nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre.</p> <p><i>Evidenca nr. 12. Rregullore e standartizimit të procedurave për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentave;</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore në KUR ka nisur përdorimin e një sistemi të brendshëm menaxhimi administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Aktualisht janë ndërtuar databazat në gjuhën shqipe dhe italiane dhe po aplikohen funksione të veçanta të sistemit.</p> <p>KUR i mban të dhënat në dy formate: dosje fizike dhe version elektronik. Informacioni i versionit elektronik administrohet bazuar dhe miratuar me Vendim Nr. 34, datë 09.05.2020 të Senatit Akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë</p>	<p><i>Evidenca nr. 13. Rregullore e Mbrojtjes së të Dhenave Personale;</i></p>




<p>personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit, bazuar në <i>(Evidenca nr. 13. Rregullore e Mbrojtjes së të Dhenave Personale)</i> miratuar me Vendim Nr. 34, datë 09.05.2020 të Senatit Akademik. Gjitashtu, KUR ka database për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për studentët, në rrugë elektronike, në gjuhën shqipe dhe italiane, që i nështrohet rregullave të mësipërme.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” ka platformën e integruar www.unirelad.edu.al që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. KUR i mundëson cdo personeli dhe studenti postën elektronike: emër.mbiemër@unireald.edu.al. GVJ evidenton si praktikë të mirë ngritjen e një sistemi të tillë manaxhimi që u mundëson studentët për marrjen e informacionit të duhur për vlerësimin etyre apo informacione të tjera gjatë zhvillimit të programit mësimor. Në të njëjtën kohë ky është prej kushteve të plotësuara nga rekomandimet e mëparshme.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi është në proces implementimi dhe referuar deklarimit të përgjegjësit të IT, Platforma dhe sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit, bën të mundur monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrative, si dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Komunikimi midis stafit akademik studentë realizohet nëpërmjet e-mail, platformës www.unireald.edu.al i cili siguron komunikim interaktiv midis studentëve dhe pedagogëve apo platforma on line Goole classroom, për të cilin janë hartuar dhe udhësuesit përkatës (<i>takimi me studentet</i>), [Google Classroom Manuali student.pdf; [Manual për programin OBS për regjistrim Video dhe audio.pdf; [Google Classroom Manual pedagogu.pdf.]</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Institucioni ka krijuar infrastrukturën për monitorimin e e aktivitetit akademik dhe administrativ apo raportimin e brendshëm që realizohet nëpërmejt komunikimit me emalin e brendshëm zyrtar emer.mbiemer@unireald.edu.al [takimi me stafin drejtues dhe studentë, pedagogë]</p> <p>Institucioni disponon faqen e tij të internetit www.unireald.edu.al] e cila përmban informacione të vlefshme për informimin e publikut. Faqja e internetit ofrohet vetëm në gjuhën shqipe. Informacionet në lidhje me programet e studimit, përmbajtjen, strukturën/organigramën</p>






	përditësohen dhe publikohen ne faqen e universitetit. Cdo informacion që lidhet me programin e studimit personelin akademik dhe aktivitete që kryen KUR, publikohen në faqen e internetit http://unirelad.edu.al/en/homepage , në tre gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe, dy të tjerat italiane dhe angleze.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson përpjekejn e isntitucionit për implementimin e një sistemi të brendshëm të menaxhimit institucional, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Fazat e implementimit dhe funksioniltetet që do të mundësojë duhet të vlerësohen në fazën përfundimtare të implementimit të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Menaxhimi financiar i Institucionit është i lidhur me aktivitetin e bizneseve, pjesë e shoqërisë themeluese. Financat e institucionit administrohen nga Bordi i Administrimit.</p> <p>Referuar Statutit të KUR (Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD) institucioni çdo vit harton buxhetin bazuar në propozimet e njësisë dhe strukturave të kolegjit. GVJ-së iu vunë në dispozicion të dhëna mbi procedurën e hartimit të buxhetit, alokimin dhe realizimin e tij në nivel institucional dhe të programit të studimit. Nga takimi me përfaqësuesit e Bordit, u deklarua se ky proces realizohet. (takim me ZBNJ & ZF).</p> <p>Kolegji Universitar “REALD” përmes Bordit të Administrimit, harton raport financiar të kostove të programit të studimit BSc në Infermieri. Sipas raportit te BA, kosto për një student në infermieri është 1500 Euro. Gjithashtu, në raporitn financiar, sigurimi i të ardhurave për zhvillimin e programit, mbështet në 3 burime:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. tarifat e shkollimit;

	<p>2. projekte të përbashkëta;</p> <p>3. investime nga veprimtaria e biznesit e shoqërisë themeluese “ESKELD”;</p> <p>Në bilancin e paraqitur nga ESKELD Shpk për vitin 2021, nuk del në pah aktiviteti financiar i KUR për të gjykuar nëse institucioni ka ecuri financiare pozitive. Megjithatë, në takimin me drejtuesit, u deklarua se institucioni ka mbështetje financiare nga shoqëria themeluese.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Referuar raportit financiar mbi kostot e programi të studimit GVJ konstatoi se institucioni ndjek politikën e dhënies së bursave në nivelin 100% për studebtët me note mestare 10, dhe 50% për kategoritë në nevojë dhe studentët me aftësi ndryshe, dhe për studente me mesatare note 9.6. (<i>Evidenca nr. 91. Raport financiar mbi koston e programit të studimit Bachelor ne Infermieri</i>)</p> <p>Në raportin financiar të përgatitur nga Bordi Administrimit, për financimin e programit të studimit Bsc në Infermieri janë të përcaktuar zërat e shpenzimeve si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mësimdhënie – 10%; - kërkim shkencor – 10%; - zhvillimin e personelit – 10%; - infrastrukturën – 10%; - paga personeli – 50%. <p>Ajo që vihet re në raportin e paraqitur apo deklaratimet e institucionit, mungon vlerësimi në total i raportit të të ardhurave dhe shpenzimeve lidhur me numrin aktual të studentëve, nivelin e bursave të dhëna apo vlerësn e investimeve të kryera në vite (edhe pse deklarohet 10 %)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Kolegji Universitar “Reald” si pjesë e subjektit juridik SHpk ESKELD, kryen auditim financiar periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij, të kërkuar sipas ligjit, në mbyllje të çdo viti financiar. <i>Bilanci i ESKELD SHPK i paraqitur në organet tatimore për vitin 2021;</i></p> <p>Sipas deklaratimeve, përdorimi i fondeve ka shkuar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, investimit në laboratorë dhe auditorë, shtimit të titujve në bibliotekë, proceseve të informatizimit, punësimit të stafit akademik të kualifikuar, financimit të veprimtarive shkencore, por kërkohet informacion të detajuar për shpërndarjen e fondeve sipas zërave të caktuar. GVJ evidenton të dhëna financiare të cilat</p>





	<p>janë për të gjithë shoqërinë në tërësi. <i>Por rekomandohet të ndahet buxheti i institucionit nga buxheti i shoqërisë për të analizuar më qartë ecurinë e institucionit.</i></p> <p>GVJ evidentoi financime të kryera në funksion të mbështetjes së stafit dhe studentëve por ato janë kryesisht të miratuara bazuar në kërkesa sesa në formën e një buxheti të strukturuar dhe të miratuar në fillim të vitit akademik në nivel njësie kryesore apo njësi të tjera të kolegjit.</p> <p><i>Vendim i BA për miratim fondi për Këshillin Studentor; Vendim i BA për miratim fondi për Kërkimin Shkencor; Vendim i Bordit të Administrimit për trajtim të studentëve me status të veçantë;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Bazuar në rrgulloren e përgjithshme të KUR, njësitë bazë dhe ato kryesore vihen në dijeni mbi realizimin e buxhetit të miratuar të viti paraardhës. <i>Rregullore e Përgjithshme e IAL</i> KUR është një institucion jopublik i arsimit të lartë dhe si i tillë ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentet shoqëruese deklarohet se burime të financimit janë tarifatat e studentëve (regjistrimit dhe shkollimit), të ardhurat nga projektet me IAL të tjera investime nga veprimtaria e biznesit të shoqërisë themeluese/ kompania mëmë. Bazuar në deklaratimet e personelit akademik, GVJ evidentoi mbështetje të ulët financiare nga projekte apo financime nga programe të ndryshme në nivel kombëtar si AKKSHI, MAS etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” duke qenë pjesë e subjektit juridik SHPK ESKELD, por edhe nga analiza financiare e veprimtarisë së tij, garanton qëndrueshmërinë financiare.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion në takim me drejtuesit u deklarua se institucioni është me fitim, dhe investimet i bazojnë në studimin e tregut të punës, kërkesat në rritje për infermierë për shkak të largimit të stafit infermieror në emigracion, duke përbushur dhe misionin e KUR për ti shërbyer vendit në plotësimin e nevojave për personel infermieror. Megjithatë, bazuar në numrin e studentëve të regjistruar/diplomuar në programin e studimit, <i>rezulton se të ardhurat e siguruar vetëm nga tarifatat e studimit, nuk janë të mjaftueshme për të garantuar ecurinë normale të zhvillimit të veprimtarive akademike e shkencore.</i></p> <p><i>Bilanci i ESKELD SHPK i paraqitur në organet tatimore për vitin 2021</i></p>

	Për më tepër, pamundësia për të gjeneruar burime alternative financiare, nuk mundëson investime në përmirësimin e infrastrukturës fizike e logjistike, rekrutimin e personelit akadmeik të kualifikuar apo përdorimin e stimujve financiarë në kuadër të promovimit të personelit akademik			
Konkluzione	<p><i>Kolegji Universitar "REALD" garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimit-kërkimor, nga tarifa e studentëve dhe të ardhura të tjera të kompanisë themeluese.</i></p> <p><i>Megjithatë institucioni duhet të shohë mundësi alternative për gjenerimin e të ardhurave në mënyrë që të garantojë ecurinë afatgjatë të programit dhe institucioni në tërësi</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	KUR është institucion jo publik i cili bazon aktivitetin e tij në bazën ligjore aktuale në fuqi. Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e kolegjit. Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të miratuara nga Senati Akademik, zbaton procedura, të cilat garantojnë të drejta të njëjta, për të gjithë studentët. Mundësohet ndjekja korrekte e kandidatit që nga momenti i aplikimit deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Çdo student që paraqet kërkesë për transferim për largim apo kalim në Kolegjin Universitar “REALD”, ka të drejtë ta realizojë këtë në bazë të rregullores dhe legjislacionit në fuqi.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat e Kolegjit Universitar “Reald” garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta, për të gjithë studentët, duke informuar studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme. Duke u bazuar në të dhënat e marra në takimin e GVJ dhe në <i>Evidencën nr. 4/ Rregullore e Përgjithshme, neni 69</i> , studenti ka të drejtë të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e parapara me Statut. Po ashtu, studenti përdorë pajisjet, materialet e ndryshme klinike e ato laboratorike, bibliotekën e Kolegjit, gjithmonë duke u bazuar në plan program. Studenti ka të drejtë të përfitojë bursë, të shprehë mendimin e tij/saj apo të ankohet në rast të shkeljes së rregullave dhe standardeve akademike.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas	Në fazat e regjistrimit, institucioni publikon kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve (<i>faqja e internetit KUR</i>). Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision i caktuar nga dekanati mbështetur në dokumentacionin e paraqitur, notës mesatare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe Vendimeve të Senatit Akademik <i>Evidenca nr. 7. Rregullore e programit Ba. në Infermieri-miraturar me Vendim nr. 5 dt. 25.02.2022 te SA;</i> Institucioni publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në



<p>ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Referuar analizës së bërë nga ana e institucionit rezultoi se rezultatet e studentëve në bachelor janë më të larta se ato të marra në shkollën e mesme.</p> <p>Procedura e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme është e mundur, por në programin e studimit nuk ka patur raste.</p> <p><i>Ndërkohë sikundër kemi theksuar, në institucion mungon një strukturë e posacme që merret me analizën, vlerësimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve gjatë studimeve akademike.</i></p> <p>NJSBC në disa raste është angazhuar por nuk akrezultate të prekshme për monitorimin e studentëve.</p> <p><i>Vendim nr. 30, datë 10.02.2020, i SA, për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2021-2022;</i></p> <p><i>Plan pune i NJSBC;</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Në takim me studentët ata deklaruan se informohen në fillim të çdo viti akademik në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Në takimin me Dekanin e Fakultetit dhe studentët rezultoi se Fakulteti në bashkëpunim me Këshillin Studentor organizon aktivitete informuese për maturanët e shkollave jo vetëm të Vlorës, por edhe të rretheve të tjera. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në Programin BSc. “Infermieri”, janë të përcaktuara në Statutin e Kolegjit Universitar “Reald”, neni 67, “Pranimi në ciklin e parë të studimeve” si dhe Nenin 76 “Programet e ciklit të parë”, organizimi i tyre, dhe hyrja e studentëve në program bazohet në legjislacionin në fuqi. Senati Akademik ka marrë Vendimin Nr. 1 datë 12.01.2022 “Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024”, ku kriter është nota mesatare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave.</p> <p><i>Statuti Kur;</i></p> <p><i>Rregullore e përgjithshme KUR;</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të</p>	<p>Bazuar në Vendimin Nr. 6/1 datë 12.06.2022 të Senatit Akademik “Për rialokimin e kuotave të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023, në Kolegjin Universitar “Reald”, në Programin e BSc. Infermieri, janë miratuar 90 kuota, nga të cilat janë planifikuar 60 brenda vendit, 10</p>

veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	program të dytë, 10 për transferim studimesh 5 të huaj dhe 5 nga Kosova.								
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Bazuar në Statutin e KUR, çdo vit akademik, për të ndjekur programin e studimeve BSc. në “Infermieri” pranohen studentë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Presheva, Bujanovci, Medvegja, Mali i Zi, Italia dhe nga vende të tjera të BE, pasi kandidatët kryejnë procedurën e njohjes së diplomave të fituara jashtë vendit pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.								
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Kandidati fitues ka të drejtë të ndjekë studimet në Programin BSc në “Infermieri”, për të cilin aplikoi nëse regjistrohet në Sekretarinë Mësimore brenda afateve të parashikuara. Me regjistrimin ai fiton statusin e studentit dhe të gjitha të drejtat që burojnë prej tij duke përfshirë edhe politikatatndihmëse/bursat. <i>Vendim i Bordit të Administrimit për trajtim të studentëve me status të veçantë;</i>								
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar “Reald” përmes Senatit Akademik ka hartuar, ndjek e zbaton politika dhe procedura për pranimin e studentëve, përzgjedhjen e tyre, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit BSc në Infermieri.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në web faqen e Kolegjit Universitar Reald (unireald.edu.al), Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në web faqe përshkruhet procedura e kalimit nga një vit në tjetrin/përmbushja e 30 ECTS. Ndërkohë janë të publikuara rregulloret e institucionit, programeve, njëjive kryesore dhe baze, etj

<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Programit BSc në “Infermieri” /miratuar me vendim nr. 39, datë 10.09.2020 të Senatit Akademik/, studenti kalon nga viti i parë në vitin e dytë, kur ka siguruar të paktën 30 kredite të vitit të parë. Studenti kalon nga viti i dytë në vitin e tretë, kur ka siguruar të paktën 60 kredite nga viti i parë dhe i dytë. Studenti kalon nga viti i tretë në vitin e katërt, kur ka siguruar të paktën 110 kredite nga viti i parë, i dytë dhe i tretë. Studenti kalon nga viti i katërt në vitin e pestë, kur ka siguruar të paktën 150 kredite nga viti i parë, i dytë, i tretë dhe i katërt. Studenti i vitit të fundit që në përfundim të provimeve të vitit rezulton me 30 kredite të pashlyera, ka të drejtë t’i likuideoje ato në një periudhë të caktuar nga dekanati, përpara sezonit të diplomimit. Studenti që shlyen këto detyrime, lejohet të hyjë në mbrojtjen e diplomës. Në rast të kundërt, i lind e drejta e shlyerjes së tyre në sezonin e riprovimeve të vjeshtës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në <i>(Evidencën nr. 4 / Rregullore e përgjithshme, Kreu VII Kontrolli i Dijes, Neni 57/ Sistemi i Vlerësimit)</i>, institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash 1 deri te 10. nota më e ulët kaluese është nota 5 (pesë). Në procesverbalet e vlerësimit përfundimtar për studentin jo kalues (ngelës) vendoset nota 4 (katër). Në të gjitha format e kontrollit të dijës përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat e diplomimit janë paraqitur në kurrikulat e çdo program studimi. Sekretaria mësimore është e detyruar t’i përcjellë me shkresë të veçantë përgjegjësit të departamentit dhe dekanit të fakultetit listën e studentëve që kanë plotësuar detyrimet e një programi studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar të cilët kanë të drejtën e provimit të formimit ose mbrojtje e tezës së diplomës. Sekretaria mësimore mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave. Përgjegjësi i departamentit pas marrjes së listës së studentëve ngre një komision ad hoc, i cili verifikon nëse këta studentë kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit. Pas verifikimit lista e studentëve që kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës, ose provimin e formimit e firmosur nga anëtarët e komisionit, i përcillet përgjegjësit të departamentit. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të parë, për</p>






	fitimin e diplomës parashikohet provimi final ose përgatitja e punimeve të diplomës..			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Kolegji universitar Reald, publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Këshillimi akademik që ofron Kolegji ka për synim të orientojë dhe ndihmojë studentët mbi mundësitë e paraqitura, duke vlerësuar alternativat e mundshme.			
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar "Reald" ka vendosur në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bsc në Infermieri informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve. Informacion të plotë jepet edhe në rregulloren e programit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	



Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Në Rregulloren e përgjithshme, është përcaktuar se informimi i studentëve realizohet nga personeli akademik dhe sekretariatë mësimore. Informimi i studentëve mbi programin të studimit, përmbajtjen e lëndëve, kryehet nga personeli akademik. Ndërsa sekretaria mësimore i informon ata për organizimin e programit të studimeve, rezultatet etj. Informimi fillon me takimet me studentët e ardhshëm (maturantë në gjimnaze të ndryshme). Informimi kryehet edhe nëpërmjet broshurave/fletpalosjeve informuese
	<i>Rregullore e përgjithshme KUR; Kalendari për informimin e nxënësve maturantë për vitin akademik 2022-2023 dhe 2023-2024; Fletë-Palosje e IAL për programet e studimit të ofron KUR;</i>






<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Programi i studimit dhe plani mësimor përmbajnë informacionin me kohëzgjatjen e studimeve dhe ngarkesën në orë dhe kredite. KUR vë në dispozicion të studentëve informacione dhe dokumente për zhvillimin e veprimtarive mësimore is udhëzues për provimet, rregullore, manual për përdorimin e classroom për studentin, udhëzues për hartimin e diplomës.</p> <p><i>Evidenca nr. 47. Programi mesimor Bachelor në Infermieri 2020-2023 - i riorganizuar;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 49. Plani mesimor bachelor ne Infermieri- i riorganizuar. Viti akademik 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca, 42, 43 45;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka kryer një studim të tregut të punës nëpërmjet të cilit arrin në konkluzionin se programi i studimit është mjaft i kërkuar dhe se punësimi i studentëve të diplomuar është mjaft i lartë. Programi rezulton të jetë i kërkuar nga tregu i punës në rajonin e Vlorës. Shumica e tyre ishin në marrëdhënie pune në institucione të ndryshme shëndetësore Edhe në takimin me studentët një pjesë e tyre konfirmuan se ishin në marrëdhënie pune. Syllabuset tregojnë shkurtimisht detyrimet e studentit në lidhje me lëndën/modulin. <i>(takimi me studentet)</i></p> <p>Ndersa Zyra e këshillimit të karrierës, është në dispozicion të studentëve për të ndihmuar që secili prej tyre të zgjedhë orjentimin dhe programin e duhur, në përputhje me prirjet, talentin dhe planin individual të karrierës. Veprimtaria e zyrës së këshillimit të karrierës orjentohej drejtë informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre që në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre ofron, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj. Gjthashtu, zyra e zhvillimit të karrierës ofron asistencë për cdo student në disa drejtime kryesore si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zgjedhja e programit të studimit dhe paketa e lëndëve të secilit program; - Organizimi i praktikave dhe programeve të shkëmbimit sipas secilit program; - Përfshirja në aktivitete akademike dhe profesionale sipas secilit program; - Mundësitë e punësimit sipas secilit program studimi, etj. <p><i>Rregullore e Zyres se Këshillit të Karrierës;</i> <i>Studim i tregut te punes ne fushen e shkencave mjekesore;</i> <i>Te dhena mbi punesimin e studenteve te diplomuar;</i> <i>Të dhëna të punësimit në IAL të studentëve të diplomuar në Kolegjin Universitar Reald;</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion</p>	<p>Në takimin me studentët, u evidentua se ngaqë shumica janë në marrëdhënie pune, nuk e kanë patur të nevojshme ndihmën e</p>



<p>informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>zyrës. Në rregulloren e zyrës institucioni deklaron se procesi i zhvillimit dhe këshillimit të karrierës është i lidhur ngushtësisht me formimin akademik të studentëve, të ardhmen e të cilëve institucioni e sheh të lidhur edhe me mundësinë e punësimeve në institucionet jashtë vendit. Por njëkohësisht studentëve ju krijohet mundësia që nëpërmjet iniciativave publike e private, konferencave, leksioneve të hapura, serive të diskutimeve dhe debateve periodike, projekteve studentore në partneritet, si dhe përmes një numri të madh aktiviteteve ekstra- kurrikulare, jo vetëm të përgatiten profesionalisht, por të kenë qasjen korrekte ndaj botës akademike, duke formuar një profil akademik individual, i cili do t'ju vlejë në karrierën e nesërme, por edhe në studimet e mëtejshme.</p> <p><i>Evidenca nr. 15. Rregullore e Zyres se Këshillit të Karrierës;</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në takimin me studentët, u deklarua se ata kanë informacionin për programin e studimit. dhe mbështetjen nga ana e institucionit. Institucioni ka në aplikim dhe është drejt finalizimit të të menaxhimit të brendshëm i cili do të lehtësojë komunikimin me studentët e programit dhe personelin akademik. Aktualisht sistemi mundëson kryesisht informimin mbi rezultatet e provimeve dhe informacion mbi pagesat.</p> <p>Ne e konsiderojmë aplikimin e këtij sistemi si praktikë të mirë dhe një veprim në kuadër të plotësisht të rekomandimeve të lëna. Institucioni ofron për studentët e-maile dhe informim të drejtpërdrejtë.</p> <p><i>Database për ruajtjen në formatin elektronik të dokumentacionit dhe të dhënave personale të studentit në gjuhën shqipe;</i></p> <p><i>Vizita ne institucion;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon se në përgjithësi sistemi i informimit të studentëve funksionon pasi vetë studentët deklarojnë se janë të informuar dhe mbështeten nga institucioni. Institucioni ka informacione mbi tregun e punës dhe studentët orientohet nëpërmjet zyrës së karrierës. Aplikimi i një sistemi të informatizuar konsiderohet praktikë e mirë nga ana e GVJ</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi V.4






Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																									
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore, disponon të gjithë informacionin e plotë mbi numrin në hyrje dhe atë në dalje të studentëve të tij. Çdo student i regjistruar në KUR, gjendet në Regjistrin bazë të studentëve, ecuria e tyre gjatë studimeve. Sekretaria mësimore mbledh dhe mban të dhëna në formë elektronike për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Në vitet e fundit në programin e studimit janë diplomuar përkatësisht, një numër i ulët studentësh.</p> <p><i>Evidenca nr. 73. Të dhëna për numrin e të diplomuarve ne Ba. Infermieri, te punesuar ne 5 vitet e fundit;</i></p>																									
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Të dhënat statistikore administrohen nga Sekretaria mësimore, e cila ruan evidencat dhe dosjet e plota të çdo studenti. Kjo u evidentua dhe në takimin që GVJ realizoi në sekretarinë mësimore. Në statistikat e vëna në dispozicion të GVJ, është kryer edhe analiza mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe ecuria e tyre gjatë studimeve. Nisur nga numri i ulët i studentëve, institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, ruan kontakte të drejtpërdrejta me studentët dhe i asiston ata në punësimin e shpejtë të tyre dhe ndjekjen e ecurisë në profesion. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kërkuar gjatë vizitës në institucion (<i>Të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar largimet para përfundimit të programit Ba</i>), numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi rezulton:</p> <table border="1" data-bbox="555 1328 1342 1776"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr i të regjistruarve</th> <th>Nr i të transferuarve</th> <th>Nr i të cregjistruarve</th> <th>Nr aktual</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>0</td> <td>21</td> <td>0</td> <td>21</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>72</td> <td>0</td> <td>18</td> <td>54</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>44</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>44</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td colspan="4">119</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të transferuarve	Nr i të cregjistruarve	Nr aktual	2020-2021	0	21	0	21	2021-2022	72	0	18	54	2022-2023	44	0	0	44	Totali	119			
Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të transferuarve	Nr i të cregjistruarve	Nr aktual																						
2020-2021	0	21	0	21																						
2021-2022	72	0	18	54																						
2022-2023	44	0	0	44																						
Totali	119																									
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të</p>	<p>Nga takimi që GVJ realizoi me sekretarinë mësimore evidentoi se sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbarëvajtjen e të dhënave të ecurisë së studentëve në programin e studimit dhe atë meanë të regjistrave të notave dhe të frekuentimit, regjistrat</p>																									

<p>brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>të gjeneraliteteve, dosjeve të studentëve, përgjatë 5 vitëve të ciklit të studimit. Dosjet e studentëve ruhen në sekretarinë mesimore. <i>Evidenca nr. 16. Rregullore e Sekretarise Mesimore;</i></p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mesimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ identifikoi procedurën e ruajtjes dhe arkivimit të informacionit. KUR ka një rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit. Nga vizita u konfirmua se dokumentacioni ruhet e arkivohet në formë leketronike dhe në letër. Dosjet e studentëve dhe historiku i tyre është lehtësisht i gjurmueshëm në institucion. Regjistri i studentëve në përgjithësi ishte i plotësuar rregullisht përvec raseve të studentëve të pa pajisur me numër matrikullimi.</p> <p>Në Kolegj mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialiteti bëhen në përputhje me legjislacionin specifik në fuqi/ <i>Neni 84 - Mbrojtja e të dhënave/</i>. Edhe studentët u shprehën të kënaqur me sistemin e menaxhimit.</p> <p><i>Rregullore e standardizimit te procedurave per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve – 2020;</i></p>		
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në nivel institucioni, funksion sekretaria mesimore, e cila ka funksionale një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e studentëve dhe mbështetjen e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mesimor. Rol kryesor në këtë drejtim luan koordinatori i programit të studimit</p> <p><i>GVJ identifikoi gjurmim jo të mirë të studentëve të diplomuar. Edhe pse institucioni deklaroi se ka nivel të lartë të punësimit, nuk jepen të dhëna të plota për të gjithë studentët e diplomuar në vitet e fundit.</i></p> <p><i>Rregullore e Sekretarise Mesimore;</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kolegji Universitar “Reald”, përmes Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së Karrierës, mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Mungon ndërveprimi me studentët e diplomuar</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	



Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në dokumentet kryesore të institucionit (statuti, rregullorja e përgjithshme etj), studentët janë të përfshirë në strukturat vendimmarrëse të KUR. Studentët janë të organizuar në strukturat studentore në nivel fakulteti dhe në nivel kolegji. Edhe në takimin me studentët ata deklarojnë se janë të përfshirë dhe pyeten nga drejtuesit e institucionit. Në takimin me studentët dhe shqyritmi i evidencave, rezulton se studentët janë pjese aktive dhe e rëndësishme e organeve përfaqësuese dhe administrative.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Sic u konfirmua dhe nga takimi me studentët ata gjejnë mbeshteje të vazhdueshme nga stafi akademik dhe administrativ për sa i përket ecurisë dhe ngarkesës mësimore që ata kanë. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik është e mundur bazuar në aktet rregullatore. Nga takimi me studentët rezultoi se studentët nuk përfshihen në veprimtaritë e institucionit dhe vendimmarrjes. Gjithsesi, ky tregues është mirëkuptuar nga ana jonë me situatën e krijuar nga pandemia Covid 19 ku shumica e veprimtarive akademike e administrative në dy vitet 2020 -2022 janë zhvilluar online. <i>Rregullore e përgjithshme KUR;</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Studentët japin mendime për procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit, cilësinë e mësimdhënies dhe të programit të studimit si dhe lidhur me çështje të ndryshme, si tarifatat e studentëve, kurrikulat e programeve, projektet kërkimore shkencore, praktikatat, sezonet e provimeve etj. Veçanërisht studentët vlerësojnë angazhimin e institucionit në zhvillimin e praktikave profesionale, mbështetjen për punësim. Megjithatë GVJ mendon se ka hapësira për angazhim më të madh të studentëve në veprimtari të ndryshme nëpërmjet motivimit apo promovimit tyre. <i>takimi me studentët;</i>

<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në mënyrë periodike Kolegji kryen aktivitete, duke nisur nga Konferencat Kombëtare të shkencave mjekësore ku studentët marrin pjesë në mënyrë aktive duke punuar tema shkencore dhe eksperimentale nën udhëheqjen e profesorëve, trajnimet me tematika të ndryshme brenda e jashtë vendit (aktivitete studentore). GVJ konstaton angazhim të ulët të studentëve në veprimtari jashtë procesit mësimor.</p> <p>Ndërkohë, lidhur me komunikimin dhe respektimin e të drejtës për të dhënë mendime, duket se studentët e kanë këtë lirshmëri. Në takimin me studentët, ata shprehin se kanë bashkëpunim të ngushtë me personelin akademik dhe se atyre u mundësohet dhënia e mendimit gjatë procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës. <i>Takimi me studentët]</i></p> <p><i>Vendim i SA për miratimin strukturës së Sigurimit të Cilësisë dhe të Këshillimit të Karrierës;</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kolegji Universitar "Reald" përfshin dhe angazhon studentët në Senatitn Akademik, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Një përfaqësues i Këshillit Studentor është anëtar i Senatit Akademik.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore</p>	<p>Institucioni, në organikën e tij ka Zyrën e Këshillimit të Karrierës, zyrë e cila në funksionin e saj ka pikërisht informimin e studentëve. Përveç kësaj zyre, në funksion të informimit të studentëve është edhe koordinatori i programit i cili nuk rezulton të jetë parashikuar në Rregulloren e programit të studimit. Institucioni ka hartuar edhe rregulloren e këshillimit të karrierës në shërbim të studentëve.</p>



dhe aktet rregullatore të institucionit.	<i>Rregullore e programit Ba. në Infermieri- miratuar me Vendim nr. 5 dt. 25.02.2022 te SA;</i> <i>Evidenca nr. 15. Rregullore e Zyres se Këshillit të Karrierës;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni për ndjekjen e ecurisë dhe përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Këtë rol e kryen sekretaria mësimore e cila ndjek ecurinë e studentëve gjatë vitit akademik. Studentët marrin në këtë strukturë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe dokumente që iu nevojiten. Sic u konfirmua dhe nga takimi me studentët ata gjejnë mbështetje të vazhdueshmë nga stafi akademik dhe administrative për sa i përket ecurisë dhe ngarkesës mësimore që ata kanë. Por ndëkohë ka një zyrë / person të angazhuar në këshillimn e karrierës e cila si rol kryesor ka orientimin e studentit drej ttreegut të punës. <i>Rregullore e Sekretarise Mesimore;</i> <i>Rregullore e Zyres se Këshillit të Karrierës;</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në rregulloren e përgjithshme, si strukturë ekziston zyra për këshillimin e karrierës. Sikundër u theksua më lart, si nga studentët edhe nga dokumentacioni në dispozicion, rezulton se është sekretaria mësimore struktura që mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike. Informacioni i dhënë është kryesisht për orientimin e studentëve në lidhje me procesin mësimor, orientimin për praktikën profesionale etj. Punësimi më së shumti realizohet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve individuale që personeli akademik ka. Studentët japin mendime për procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit, cilësinë e mësimdhënies dhe të programit të studimit si dhe lidhur me çështje të ndryshme, si tarifrat e studentëve, kurrikulat e programeve, projektet kërkimore shkencore, praktikat, sezonet e provimeve etj. <i>Evidenca nr. 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL;</i> <i>Takimi me studentët;</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e	Në mënyrë periodike Kolegji kryen aktivitete, duke nisur nga Konferencat Kombëtare ku studentët marrin pjesë në mënyrë aktive duke punuar tema shkencore dhe eksperimentale nën udhëheqjen e profesorëve, trajnimet me tematika të ndryshme brenda e jashtë vendit (aktivitete studentore). Referuar takimit me studentët, KUR ofron këshillim apo orientim karriere. Megjithatë informacione të tjera mbi aktivitetet kërkimore, angazhime në projekte apo studime, informacione mbi mobilitetet, rezultojnë të jenë të limituara Shumica e

autoriteteve drejtuese përkatëse.	veprimtarive janë të organizuar me komisione ad-hoc dhe nuk përfaqësojnë struktura të përhershme. <i>Rregullore e Zyres së Këshillit të Karrierës;</i>			
Konkluzione	<i>KUR ka truktura për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Ata kanë të drejtë të përfshihen dhe angazhohen në jetën akademike të institucionit por GVJ identifikoi një angazhim të ulët të tyre. Një përfaqësues i Këshillit Studentor është anëtar i Senatit Akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	KUR ka të ngritur në nivel institucional Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) e cila funksionon në bazë të statutit dhe rregullores. Koleji Universitar “REALD” ka miratuar “Rregulloren e sigurimit të brendshëm të cilësisë” me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, ku përcaktohet që cdo fillim viti akademik vlerësohen dhe përmirësohen metodat mësimdhënëse, sipas lëndëve dhe fushës së studimit. Gjithashtu, KUR ka hartuar udhëzuesit përkatës për përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe studimit, si Google classroom dhe programin OBS për regjitrin video dhe audio të leksioneve.

	<p><i>Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD;</i> <i>Evidenca nr. 4. Rregullore e Pergjithshme e IAL;</i> <i>Evidenca nr. 14. Rregullore e NJSBC;</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>NJSBC përpiqet për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë të cilat kanë nevojë të konsolidohen dhe të standartizohen si procese permanente që kryhen në nivel institucional dhe në nivel programi studimi duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. KUR ka Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë bazuar në “Rregulloren e sigurimit të brendshëm të cilësisë” me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, detyrë e së cilës është monitorimi përmes mekanizmave të ndryshëm, si anketa e zhvilluar me studentët, të metodave të mësimdhënies nga ana e personelit akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>KUR nëpërmjet NJSBC garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përmes anketave dhe plotësimit të pyetsorëve në mënyrë anonime. NJSBC përgatit raport vjetor duke analizuar informacion e mbledhur nga anketimi i studentëve. Edhe proceset që kryhen gjatë vitit akademik të parashikuara në planin vjetor të punës, më tepër janë aktivitete të institucionit se sa një politikë e qartë me mekanizma dhe aktivitete për sigurimin e cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC bën publike rezultatet e vlerësimit vjetor në web faqen e KUR www.unirelad.edu.al, i cili është i aksesueshëm nga studentët dhe publiku.</p> <p>Në këtë drejtim KUR duhet të ndjekë politika të qarta të cilat realizohen nëpërmjet procedurave periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>KUR nga vlerësimet e kryera përmes anketimeve të studentëve, bën të mundur të nxjerrë në pah praktikata e mira të përmenduar nga studentët, çfarë motivon personelin akademik të përmirësojë metodat e mësimdhënies. Këto procese të realizohen duke përfshirë të gjithë kontribuesit e institucionit që të ndihmojnë në krijimin e kulturës së cilësisë në nivel institucional.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kolegji Universitar “Reald” ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), që garanton dhe</i></p>

	<i>promovon cilësinë e mësimdhënies, si dhe ka udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave për monitorimin e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	KUR ka një strukturë të quajtur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bazuar në “Rregulloren e sigurimit të brendshëm të cilësisë” miratuar me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Kreu X, 2, bazon punën e saj në statutin e institucionit dhe të gjithë akteve rregullatorë të brendshëm. <i>Evidenca nr. 14. Rregullore e NJSBC;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Kolegji Universitar “REALD” ka miratuar “Rregulloren e sigurimit të brendshëm të cilësisë” me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik, dhe bazuar në këtë rregullore ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila është struktura përgjegjëse për menaxhimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. NJSBC ka disa mekanizma për përmirësimin e cilësisë, ku një nga kryesorët është përfshirja e studentëve në process por edhe mbledhja e opinionit të tyre përmes anketimit studentor. <i>Evidenca nr. 14. Rregullore e NJSBC;</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë	KUR përmes NJSBC përdor instrumentë sasiore dhe cilësore për përmirësimin e cilësisë. Instrumentat cilësorë përfshijnë anketimin e studentëve, pyetsorët për pedagogët, formularin e vlerësimit të pedagoëve. Ndërsa instrumentat cilësore përfshijnë tryezat e hapura, rishikimin e literaturës për lëndën. KUR ka të angazhuar përmes NJSBC edhe një ekspert të jashtëm, i cili merret me analizimin e të dhënave të anketimit, me qëllim shmangien e biasit në rezultatet e nxjerra.

cilësinë në programin e studimit.				
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	<p>KUR përdor tregues sasiorë dhe cilësorë, bazuar në anketime dhe tryeza të hapura (fokus grupe), për mësimdhënien, dhe kërkimin shkencor bazuar në numrin e publikimeve të stafit pedagogjik. NJSBC përgatiti raportin vjetor ku nxjerr rezultatin e anketimeve apo vazhimeve të ndryshme.</p> <p><i>Evidenca nr. 89. Raport vjetor i NJSBC për vitin akademik 2021-2022;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Kolegji Universitar "REALD" ka hartuar dhe zbaton rregulloren përkatëse dhe procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në përgjithësi, dhe të BSc në Infermieri në vecanti, ku ka ngritur NJSBC si strukturë e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i></p> <p><i>NJSBC është përgjegjëse për zbatimin e gjithë instrumentave për matjen sasiorë dhe cilësorë të cilësisë në mësimdhënie, dhe rekomandimeve përkatëse. Rekomandohet që NJSBC të mundësojë pyetësor me studentët që janë diplomuar dhe janë në punë, me qëllim marrjen e opinionit të tyre për pikat e dobëta që mund të ketë programi studimit përkatës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X


Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen	KUR ka një procedurë formale e të dokumentuar për propozimin dhe miratimin e programit të studimit të ciklit të parë BSc në Infermieri. Procedura fillon me propozimin e njësisë bazë dhe të njësisë kryesore të cilat kaluan me Vendim Nr.39, datë 10.09.2020 të Senatit Akademik të






<p>periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>KUR, dhe Vendimin Nr.10 datë 11.09.2021 të Bordit të Administrimit. Ky proces i është bërë me dije Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresë Nr.79 Prot. Datë 31.03.2021, dhe aprovimin nga MASR me Urdhër Nr. 259, datë 19.07.2021. Vendimi për riorganizimin e programit Bsc në Infermieri, është bazuar në argumentimin e mos zbatimit të programit të mëparshëm për arsye burokratike nga Universiteti i Foggias.</p> <p><i>Evidenca nr. 23. Urdhër i MASR nr. 258, datë 19.07.2021, Për riorganizimin nga program i përbashkët studimi të ciklit të parë Bachelor në Infermieri, në program të ciklit;</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>NJSBC në KUR përgatit raportet e vlerësimit dhe planin e punës për aktivitetet e saj, me detyra konkrete, ku përfshihen: emërtimi, përkrahimi detyrës, periudha e kryerjes, rezultati i pritshëm. Përmes planit të punës, NJSBC adreson problematikat dhe mangësitë e vërejtura, si dhe motivon personelin akademik për përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies. Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ identifikoi rezultate të proceseve të anketimit të studentëve. Këto rezultate janë paraqitur në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin vjetor të NJSBC.</p> <p><i>Evidenca nr. 89. Raport vjetor i NJSBC për vitin akademik 2021-2022;</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara,</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit, njësia duhet të marrë rol kryesor jo vetëm në hartimin e planit të punës apo zhvillimin e pyetësorëve standartë por të përfshijë edhe metoda të tërthorta vlerësimi dhe verifikimi, të cilat sigurojnë që rezultatet e sondazheve të përafrohen realitetit në të cilin ndodhet institucioni.</p> <p>Në takimin me anëtarët e NJSBC, u deklarua se për shkak të situatës nga pandemia, zyra e ka patur të vështirë të koordinojë veprimtaritë e veta prej vitit 2020. Në vitin 2022-2023 aktiviteti i NJSBC ka qënë normal. NJSBC merr informacion të përvitshëm për provimin e shtetit dhe nivelin e kalueshmërisë së studentëve të diplomuar në KUR.</p>






<p>rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>Evidenca nr. 113. Pyetësor për kushtet ne IAL - plotësohet nga studentet;</i></p> <p><i>Evidenca nr. 114. Model pyetësori për pedagogun e lendes, i hartuar nga NJSBC - plotësohet nga studentet;</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bazuar në “Rregulloren e sigurimit të brendshëm të cilësisë”, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe të studentëve, të personelit akademik përmes formularit të pedagogut. NJSBC është duke plotësuar dhe konsoliduar veprimtarinë e vet duke u bazuar më së shumti në rekomandime dhe plane pune që adreson përmirësimin e problematikave të evidentuara.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kolegji Universitar “Reald” përmes strukturës së NJSBC, monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit BSc në Infermieri përmes metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të cilësisë së mësimdhënies, për të garantuar arritjen e objektivave formuese të programit të studimit, dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon përmirësimin e proceseve punës të cilat lidhen me analizën e informacionit apo të dhënave, raportimin dhe propozimet/rekomandimet për adresimin në të ardhmen të problematikave që kanë nevojë të përmirësohen.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi VI.4



Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Institucioni ka eksperiencë në disa procese akreditimi gjatë këtyre viteve të funksionimit të tij. Nëpërmjet akteve të tij si statut, rregullore, garanton përfshirjen e studentëve dhe personelit akademik si aktor të brendshëm në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë.</p> <p>Përfshirja e studentëve në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit <i>nuk rezulton në nivelin e duhur</i> pasi vetë studentët nuk janë të informuar mbi ndryshimet e fundit të kryera në vitin 2020 (<i>takimi me studentët</i>)</p> <p>Përbërja e strukturës së NJSBC siguron përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Ndërsa ekspertët e jashtëm janë përfshirë në studimin e tregur të punës e vlerësuar kjo pozitivisht nga ana e GVJ</p>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit është garantuar nga statuti i institucionit dhe rregullorja e KUR. Njësia bazë ka marrë rol kryesor në përmirësimin e programit të studimit. Nuk u evidentuan raste të çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	<p>KUR ka eksperiencë pozitive në angazhimin e personave të kualifikuar dhe profesionistëve si pjesë e personelit akademik me kontratë. Në këtë drejtim kontributi i tyre është i dukshëm në ofrimin e programit.</p> <p>NJSBC harton planin e veprimtarive ku parashikohen angazhime të njësisë në kuadër të monitorimit dhe vlerësimin të cilësisë në institucion. Në përgjithësi njësia harton raportime periodike të punës</p>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të	Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimin është kryesisht had-hoc por

brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	evidentohen përpjekje të cilat mund të jenë pikënisje në të ardhmen për koordinimin e proceseve në bashkëpunim me strukturat e institucionit në mënyrë që veprimtaritë e sigurimit të cilësisë mos shihen si detyrë vetëm e NJSBC por si proces në të cilin integrohen dhe përfshihen të gjithë aktorët e institucionit.						
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Ndërkohë vërehen shembuj pozitivë të angazhimit të aktorëve të jashtëm të proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë si p.sh hartimi i studimit të tregut të punës, siguron përfshirjen e aktorëve të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Eksperti i jashtëm është pjesë aktive e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit përmes anketimeve, analizimit të rezultateve dhe shkruarjes së raporti.						
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar "Reald" përmes NJSBC përfshin njësitë bazë, njësitë kryesore, personelin akademik dhe studentët në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë të programit të studimit, dhe informon studentët dhe palët e interesuara duke bërë publike rezultatet.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					


Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Kolegji Universitar "Reald" ka publikuar në mënyrë transparente dhe publike politikat, strategjinë dhe veprimatrinë e NJSBC. Gjithashtu, KUR ka të publikuara në web faqen e tij www.unireald.edu.al edhe raportet e NJSBC për çdo vit mësimor. Në faqen zyrtare të institucionit janë publikuar mjaft informacione që informojnë publikun dhe studentët e rinj. Dokumentet kryesore janë publike dhe të aksesueshme në faqen e internetit.

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Në faqen e internetit të institucionit ka informacion të limituar në lidhje me veprimtaritë në kuadër të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë për institucionin në tërësi dhe për programin e studimit në veçanti [faqja e internetit KUR].</p> <p>Në KUR respektohet liria dhe etika akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Institucioni ka “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale”.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Kolegji Universitar “Reald” i shoqëron rezultatet e vlerësimit me plan masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Plani i masave përgatiet si “Plan-masash për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit”. Një pjesë e informacioneve që lidhen me sigurimin e cilësisë janë kryesisht informuese ndërsa sikundër është deklaruar në takime, institucioni është i hapur për këdo për të dhënë informacione të detajuara në institucion në versionin e printuar apo elektronik. GVJ nuk evidentoi raste të thyerjes së lirisë akademike apo shkelje të legjislacionit për të dhënat personale [vizitë zyra e burimeve njerëzore].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar “Reald” monitoron zbatimin e masave në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, duke përgatitur “Relacion mbi zbatimin e detyrave në planin e masave”.</p> <p><i>GVJ ka vërejtur se në raportimet që janë kryer nga IAL nuk është evidentuar analizë e detajuar vlerësimi e cila në përfundim të shoqërohet me plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Konstatimi se institucioni nuk ka hartuar vlerësime, raportime, që analizojnë impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit vazhdon të qëndrojë edhe në këtë proces vlerësimi.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin</p>	<p>GVJ identifikoi veprimtari dhe informacione të limituara që lidhen me veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Gjatë takimit tme NJSBC, takimi NJSBC u deklarua se IAL organizon veprimtari periodike me</p>

afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit			
Konkluzione	<p><i>Kolegji Universitar "Reald" ka politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Proceset, veprimtaritë dhe rezultatet e tyre për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike në ëeb faen e institucionit : www.unireald.edu.al.</i></p> <p><i>Megjithatw GVJ ka vërejtur se në raportimet që janë kryer nga IAL nuk është evidentuar analizë e detajuar vlerësimi e cila në përfundim të shoqërohet me plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Infermieri.”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Marrëveshje bashkëpunimi me institucione të kujdesit shëndetësor rajonal për kryerjen e praktikave profesionale;
2. Institucioni ka investuar në laboratorë për kryerjen e praktikës profesionale dhe laboratorë të anatomisë humane, farmacisë, kimisë, informatikës për mësimdhënien;
3. Implementimi i sistemit të brendshëm informatik për menaxhimin e veprimtarive të institucionit edhe pse është në fazë implementimi;
4. Institucioni ka kornizë rregullatore të përditësuar bazuar në kornizën ligjore aktuale në fuqi.

b. Pika të dobta:

1. Të ardhurat e siguruar vetëm nga tarifat e studimit, nuk janë të mjaftueshme për të garantuar ecurinë normale të zhvillimit të veprimtarive akademike e shkencore, pavarësisht suportit financiar nga kompania që zotëron KUR; *(Standarti IV.5)*
2. Në institucion mungon një strukturë e posaçme që merret me analizën, vlerësimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve gjatë studimeve akademike; *(Standarti V.1)*
3. Institucioni nuk ka hartuar vlerësime, raportime, që analizojnë impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit; *(Standarti VI. 5)*
4. Mosmbulimi në masën 70% (52%, 72%,67%) i ngarkesës mësimore të programit të studimit nga staf akademik efektiv sipas akteve ligjore në fuqi; *(standardi IV.1)*

Rekomandime:

1. Institucioni të mundësojë sekretimin e provimeve me qëllim kryerjen e korigjimeve “blind”, duke rritur vlerësimin bazuar në meritë;
2. Institucioni duhet të vazhdojë përpjekjet për rekrutimin e personelit të specializuar në fushën e infemierisë;
3. Përbballimi i ngarkesës mësimore të programit Bachelor “Infermieri” të realizohet në masën 70% nga PAE , në plotësim të standardit të kërkuar;
4. Institucioni të vazhdojë të fuqizojë mekanizmat e sigurimit të cilësisë në kuadër të përmirësimit të saj si dhe promovimit të personelit akademik;
5. Të vazhdojë përmirësimi i kapaciteteve infrastrukture dhe logjistike në funksion të programit të studimit për realizimin e procesit të mësimdhënies;
6. Evidentim më të plotë të përdorimit të bibliotekës dhe titujve të librave sipas programit të studimit dhe të krijojë kushte për akses në bibliotekat on-line të fushës së mjekësisë të cilës i përket dhe programi i studimit;
7. Të ndahet buxheti i institucionit nga buxheti i shoqërisë për të analizuar më qartë ecurinë e institucionit;

8. Institucioni duhet të shohë mundësi alternative për gjenerimin e të ardhurave në mënyrë që të garantojë ecurinë afatgjatë të programit dhe institucioni në tërësi;
9. NJSBC të mundësojë pyetësorë me studentët që janë diplomuar dhe janë në punë, me qëllim marrjen e opinionit të tyre për pikat e dobëta që mund të ketë programi studimit;
10. Përmirësimin e proceseve punës të cilat lidhen me analizën e informacionit apo të dhënave, raportimin dhe propozimet/rekomandimet për adresimin në të ardhmen të problematikave që kanë nevojë të përmirësohen;
11. Institucioni kryen gjurmim jo të mirë të studentëve të diplomuar. Edhe pse institucioni deklaroi se ka nivel të lartë të punësimit, nuk jepën të dhëna të plota për të gjithë studentët e diplomuar në vitet e fundit;



Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Nursery"

a. Strengths and affirmations:

1. Collaboration agreements with regional healthcare institutions for offering professional practice;
2. The Institution has invested in laboratories for doing professional practice and laboratory of anatomy, pharmacist, chemistry, informatics in their premises;
3. Implementation of the internal informatic system for management of institutional activities, regardless it is in the initial phases;
4. Institution has updated regulatory framework based on the actual legal framework in power;



b. Weaknesses:

1. It seems income generated by study fees are not enough to guarantee normal progress of the scientific and academic activities, regardless the financial support by company which owns the college; **Standard IV.5**
2. Institution does not has a dedicated structure which deals with analysis, evaluation and follow up of students progress during the academic study; **Standard V.1**
3. Institution did not compile evaluation, reports, which analyse impact of activities in framework of monitoring of quality evaluation, continuing improvement of program study quality; **Standard VI. 5**
4. Institution has not guaranteed coverage of academic program by 70% (52%, 72%, 67%) by effective academic staff, according to the actual legal framework; **(Standard IV.1)**



Recommendation

1. Institution should plan to implement electronic recording of the exam thesis in order to do "blind" correction of them;
2. Institution should continue efforts to include qualified academic personnel fulfilling legal obligations specialized in nursing area ;
3. Institution should increase number of employed academic personnel in order to fulfill the criteria of 70% of didactic program is covered by them;
4. Institution to empower means of quality improvement as tool to improve of quality and academic personnel promotion;
5. Improvement of the logistic and infrastructure capacities in function of the study program in order to fulfill the teaching process;
6. Institution should provide access to on-line library specialized in the field of medicine to which belongs study program and keep track full evidence of library attendance by students and titles of books according study program;
7. To separate college budget from budget of the company owning college, in order to better analyze progress of the institution;
8. Institution can look for alternative income in order to guarantee long term progress of the program and institution as whole;
9. IQU can apply questionnaires with graduated students and are employed, in order to collect their opinion about weak points study program might have;
10. Improving working process which are connected with information or data analysis, reporting and proposals/ recommendations to address in the future all problems needed to be improved;
11. Institution should keep track of graduated students , in order to analyse the level of employment of lastly graduated students;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

